



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 paragrafi 4.1, nenin 63, nenin 64 paragrafi 2 Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.04.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Sloganit, Përmbajtjes dhe Dizajnit të Produkteve të Informimit Publik, për Realizimin e Projektit për Edukimin dhe Informimin e Votuesve të Rinj

- I. Miratohet Slogani, Përmbajtja dhe Dizajni i Produkteve të Informimit Publik, për realizimin e Projektit për Edukimin dhe Informimin e Votuesve të Rinj.
- II. Materialet si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



purple bright ideas

#KQZ 2025
ZËRI YT
VOTA
JOTE!

ZËRI YT **VOTA JOTE!** #KQZ 2025

SA ESHTE NUMRI MAJSHIMAL I KANDIDATËVE QË ZGJEDHEN?
 Për kuvendin e Kosovës zgjedhen 100 deputetë, 100 me votë direkte të votuesve dhe 20 janë ulësë të rezervuara për komunitetet jo shumicë.

Për legjislaturë komunale zgjedhen 20 përfaqësues qytetarë si që më së mëtej 50% të votave bëhet legjislaturë lokale.

Për veshitëtare komunale zgjedhen 20 përfaqësues si ka ulësë shumicë dhe komunale, politike.

KU DËSHET TË INFORMOHESH SE NË ÇILËN QENDËR TË VOTIMIT JE ÇAKTUAR TË VOTOSH?

Mund të kryesh përmes QR CODE

din
 Në Zyrën e Komitetit
 Komunal të Zgjedhjeve në
 komunën tënde

ORARI KUËR MUND TË VOTOSH
 Qendrën e votimit nga ora 7 në ora 19:00
 dhe më tej në ora 19:00

DOKUMENTET ME TË ÇILAT MUND TË VOTOSH
 Për të votuar, duhet të kesh njërin prej këtyre dokumenteve të listuara nga Departamenti i Kosovës

LETËR VOTIM
 Mënyrë e votimit

PATENTË QYLLORË
 Mënyrë e votimit

SI TË PLOTËSOSH FLETËVOTIMIN?

Në zgjedhjet për Kuvendin e Deputetëve të Kosovës, ti mund të votosh vetëm për një Subjekt Politik të ardhur në anën e majtë të fletës votimi, ndërsa në anën e djathtë mund të votosh për një ose disa kandidatë nga ai subjekt politik.

MIQZ 2025
**ZËRI YTI
 VOTA
 JOTE!**
 NËQENDRËS PËR
 VOTUESIT E REPI

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT QENDOR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion i pavarur dhe funksionon në përputhje me Kushtetut dhe Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës.

KUSH KA TË DREJTË VOTË?

Çdo qytetar mëbi 18 vjet, ose që i mblen 18 vjet në ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjedhet në nivelin bashkiqendror, nivelin shtetëror dhe nivelin ndërkombëtar, me përjashtim kur qytetari është i aftëzuar nga vendimi gjyqësor.

Ç'KA ËSHTË VOTAP?

Votap është individuale e shprehur përmes shprehjes së detyrueshme të votës dhe është themelimi i çdo personi mëbi 18 vjet.



Ç'KARË LLOJË TË ZGJEDHJEVE MUNDEN NË VENDIN TONË?

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN E KOSOVES

ZGJEDHJE PËR KUVENDIN KOMUNALE

ZGJEDHJE PËR KRYETARIN KOMUNALE

VOTA ËSHTË

Shprehja
Zgjedhja / zgjedhja e votës / votës

Shprehja
Lotë e votës / votës / votës / votës

Shprehja
Votë / votë / votë / votë

Shprehja
Votë / votë / votë / votë

Shprehja
Votë / votë / votë / votë

VOTO

PSE DUHET TË VOTOSH?

Tyja është një vendosje për përfundimin e tu të zgjedhjeve dhe të angazhimit qytetar dhe të përfundimit demokratik.

Votimi është forma më e mirë për të marrë pjesë në vendimet në vend, është një detyrim moral i secilit prej nesh, një detyrim demokratik.

Përmasë zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës e përfundimit shtetëror dhe departetit e qeverisë për formimin e qeverisë.

Përmasë zgjedhjeve për Kuvendet komunale në nivelin bashkiqendror dhe komunale të komunës tona.

KUSH GARON PËR ZGJEDHJET?



SA ËSHTË NUMRI MAKSIMAL I KANDIDATËVE QË ZGJEDHEN?

Për Kuvendin e Kosovës zgjedhen 120 deputetë, 100 me vota direkte të votuesve dhe 20 janë ulëse të rezervuara për komunitetet jo shumicë.

Për Kryetar Komune nga të gjithë kandidatët që garojnë ai që merr mbi 50% të votave bëhet kryetar i asaj komune.

Për Këshilltarë Komunale zgjedhen aq përfaqësues sa ka ulëse asambleja e komunës përkatëse.

KU DUHET TË INFORMOHESH SE NË CILËN QENDËR TË VOTIMIT JE CAKTUAR TË VOTOSH?

Mund të kyçesh përmes
QR CODE:



ose
Në Zyrën e Komisionit
Komunal të Zgjedhjeve në
komunën tënde

ORARI KUR MUND TË VOTOSH

Qendrat e votimit hapen në ora **7:00**
dhe mbyllen në ora **19:00**.

DOKUMENTET ME TË CILAT MUND TË VOTOSH

Për të votuar, mjafton të
kesh njërin prej këtyre
dokumenteve të lëshuara
nga Republika e Kosovës:



SI TË PLOTËSOSH FLETËVOTIMIN?

Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ti mund të votosh vetëm për një Subjekt Politik të renditur në anën e majtë të fletëvotimit, ndërsa në anën e djathtë mund të votosh deri në dhjetë kandidatë nga ai subjekt politik.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisanti Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



#KQZ 2025
**ZËRI YT
VOTA
JOTE!**
INFORMUES PËR
VOTUESIT E RINJ





Përmes zgjedhjeve për kuvendin e Kosovës e zgjedhim subjektin dhe deputetët e preferuar për formimin e qeverisë

Përmes zgjedhjeve për kuvendet komunale ne i zgjedhim këshilltarët komunal të komunës tonë

Përmes zgjedhjeve për kryetar komune ne e zgjedhim kryetarin e komunës tonë

KUSH GARON PËR ZGJEDHJE?



VOTA ËSHTË:

Personale
Zgjedhja i takon vetëm votuesit

E barabartë
Vota e secilit votues ka vlerën e njëjtë

E lirë
Votuesi, është plotësisht i lirë në përzgjedhjen e subjektit politik

E fshehtë
Votuesi voton në mënyrë të fshehtë.

PSE DUHET TË VOTOSH?

Vota e juaj, është zëri yt

Ti je ai që vendosë për përfaqësuesit e tu

Pjesëmarrja në votime, është tregues i qytetarisë dhe i angazhimit qytetar dhe e përmirëson demokracinë

Votimi është forma përmes së cilës ju kërkon llogari atyre që u qeverisin

Pjesëmarrja në votim, është një detyrim moral i secilit prej nesh ndaj komunitetit

ÇFARË LLOJE TË ZGJEDHJEVE MBAHEN NË VENDIN TONË?

ZGJEDHJE PËR
KUVENDIN E
KOSOVËS

ZGJEDHJE PËR
KUVENDET
KOMUNALE

ZGJEDHJE PËR
KRYETARE TË
KOMUNAVE

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet e procesit të zgjedhjeve e referendumeve dhe shpall rezultatet e tyre.

KUSH KA TË DREJTË VOTE?

Çdo qytetar mbi 18 vjet, ose që i mbush 18 vjet në ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë me zgjedhë dhe të zgjidhet, nëse është shtetas i Republikës së Kosovës, apo i plotëson kushtet, mbi Shtetësinë, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Votuesi i cili jeton jashtë Kosovës, ka të drejtë të votojë sipas ligjit dhe rregullave të KQZ-së, përmes postës ose në përfaqësi diplomatike.

ÇKA ËSHTË VOTA?

Vota është individuale e shprehur përmes vullnetit politik dhe e drejtë themelore e çdo personi mbi 18 vjeç.





ZËRI YT VOTA JOTE! #KQZ 2025

ZËRI YT VOTA JOTE! #KQZ 2025

ZËRI YT VOTA JOTE! #KQZ 2025











Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



purple bright ideas





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



purple bright ideas



EN FAZLA SEÇİLECEK ADAY SAYISI NE KADARDIR?

Kocaeli Meclisi için 120 milletvekili seçilir, 60'u seçmenlerin doğrudan oylarıyla ve 20'si 2000 nüfusa seçmenler topluluğuna ayrılmış sandalyelerle.

Belediye Başkanı için yaman adaylardan 10'dan fazla olanı alan aday 0 belediye, 1 belediye meclisinde Belediye Meclisi Üyesi için ilgili belediye meclisinde sandalye sayısı kadar temsilci seçilir.

HAİNG OYLAMA MERKEZİNDE OY KULLANMANIZI GEREKTİĞİNİ NEREDEN ÖĞRENİRSİNİZ?

Devamındaki bağlantıdan KARE KODU ile bağlantı bilirsiniz



veya
Belediye Başkanlığı Belediye
Seçim Komisyonu Ofisinden

NE ZAMAN OY VEREBİLİRSİNİZ?
Oy kullanma merkezleri saat 7:00'den
akşam 19:00'ye kapanır.

OY KULLANMA SİDASINDA KULLANABİLECEĞİNİZ BİLGİLER

Oy kullanma için Kocaeli Cumhuriyeti tarafından verilen aşağıdaki belgelerden biri yeterlidir:



OY PUSULASI NASIL DOLDURULUR?

Kocaeli Cumhuriyeti Meclisi toplantılarında oy pusulasının sol tarafında bulunan yanca bir Spat Oylama oyu verilir. Sağ Tarafa ise o Spat dışından en fazla on aday oyu verilir.

BİRSİ 2025 SENİN SESİN SENİN OYUN

GENÇ SEÇMENLERE YÖNELİK BİLGİLENDİRME



MERKEZİ SEÇİM KOMİSYONUNUN TEŞKİLATI VE İŞLEYİŞİ
 Merkezî Seçim Komisyonu seçim ve referandum sürecinde bütün işlemi yöneten en yüksek düzeydeki kurumdur. Anayasa'nın 103. maddesiyle görevleri tanımlanmıştır.

KİM OY KULLANMA MAKSİMİ SAHİPTİR?
 18 yaşını doldurmuş veya seçim gününde 18 yaşını doldurmuş her vatandaş, kendi adına Cumhurbaşkanlığı seçimine ve referandum için hak kullanabilir. Seçim günü seçimi sırasında seçime ve kayıtlı olduğu seçime girmiş ve seçime haklarını kaybetmemiş kişilerdir.

OY HEDİR?
 Oy, seçime girenlerin seçim hakkının göstergesidir. Her seçime giren vatandaşın bir oyu vardır. Oy kullanırken seçime girenlerin seçime girmiş ve seçime haklarını kaybetmemiş kişilerdir.

YURDUMUZDA NE TÜR SEÇİMLER YAPILIR?
 KOSOVA MECLİSİ
 BELEDİYE MECLİSİ
 BELEDİYE BAŞKANLIĞI

OY KULLAN

NEDEK OY VERMELİSİN?
 Kendi iradine göre seçime girenlerin seçime girmiş ve seçime haklarını kaybetmemiş kişilerdir. Kendi iradine göre seçime girenlerin seçime girmiş ve seçime haklarını kaybetmemiş kişilerdir.

SEÇİMLERDE KİM YARIŞIR?
 SİYASİ PARTİLER
 BAĞIMSIZ KANDİDLER
 BAĞIMSIZ ADAYLAR
 BAĞIMSIZ ADAYLAR

OY KULLAN

Seçim süreci seçimler sürecinin en önemli aşamasıdır. Seçim süreci seçimler sürecinin en önemli aşamasıdır. Seçim süreci seçimler sürecinin en önemli aşamasıdır.





EN FAZLA SEÇİLECEK ADAY SAYISI NE KADARDIR?

Kosova Meclisi için 120 milletvekili seçilir, 100'ü seçmenlerin doğrudan oylarıyla ve 20'si çoğunlukta olmayan topluluklara ayrılmış sandalyelerdir.

Belediye Başkanı için yarışan adaylardan %50'den fazlasını alan aday o belediyenin belediye başkanı olur.

Belediye Meclis Üyeleri için ilgili belediye meclisindeki sandalye sayısı kadar temsilci seçilir.

HANGİ OYLAMA MERKEZİNDE OY KULLANMANIZI GEREKTİĞİNİ NEREDEN ÖĞRENİRSİNİZ?

Devamındaki bağlantıdan **KARE KODU** ile bağlanabilirsiniz




veya
Belediyenizdeki **Belediye Seçim Komisyonu Ofisinden**

NE ZAMAN OY VEREBİLİRSİNİZ

Oy kullanma merkezleri saat **7:00'de** açılır ve saat **19:00'da** kapanır.

OY KULLANMA SIRASINDA KULLANABİLECEĞİNİZ BELGELER

Oy kullanmak için Kosova Cumhuriyeti tarafından verilen aşağıdaki belgelerden biri yeterlidir:



OY PUSULASI NASIL DOLDURULUR?

Kosova Cumhuriyeti Meclisi seçimlerinde, oy pusulasının sol tarafında listelenen yalnızca bir Siyasi Oluşuma oy verebilirsiniz, sağ tarafta ise o siyasi oluşumdan en fazla on adaya oy verebilirsiniz.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission





Kosova meclis seçimleri aracılığıyla hükümetin oluşumu için oluşumu ve tercih edilen milletvekillerini seçeriz

Belediye meclis seçimleri yoluyla belediyemizin belediye meclis üyelerini seçeriz

SEÇİMLERDE KİM YARIŞIR?



OY:

Şahsidir

Seçim yalnızca seçmene aittir

Eşittir

Her seçmenin oyu aynı değere sahiptir

Özgürdür

Seçmen siyasi konunun seçiminde tamamen özgürdür

Gizlidir

Seçmen gizli oy kullanır

NEDEN OY VERMELİSİN?

Oyunuz sizin sesinizdir;

Temsilcileriniz adına karar veren sizsiniz

Oylamaya katılmak vatandaşlık ve sivil bağlılığın bir göstergesidir ve demokrasiyi geliştirir

Oy vermek, yönetilenleri sorumlu tutmanın bir yoludur

Oylamaya katılmak her birimizin topluma karşı ahlaki bir yükümlülüğüdür

YURDUMUZDA NE TÜR SEÇİMLER YAPILIR?

KOSOVA MECLİSİ SEÇİMLERİ

BELEDİYE MECLİSLERİ SEÇİMLERİ

BELEDİYE BAŞKANLARI SEÇİMLERİ

MERKEZİ SEÇİM KOMİSYONUNUN TEŞKİLATI VE İŞLEYİŞİ

Merkezi Seçim Komisyonu, seçim ve referandum sürecine ilişkin tüm işlemleri hazırlayan, denetleyen, yönlendiren, doğrulayan ve sonuçlarını açıklayan daimi bir kurumdur.

KİM OY KULLANMA HAKKINA SAHİPTİR?

18 yaşını doldurmuş veya seçim gününde 18 yaşını doldurmuş her vatandaş, eğer Kosova Cumhuriyeti vatandaşı ise veya vatandaşlık koşullarını yerine getiriyorsa, bu hak mahkeme kararıyla sınırlı olması dışında, seçme ve seçilme hakkına sahiptir.

Kosova dışında yaşayan seçmen, yasa ve MSK kurallarına göre posta yoluyla veya diplomatik temsilcilik aracılığıyla oy kullanma hakkına sahiptir.

OY NEDİR?

Oy bireyseldir ve 18 yaşını doldurmuş herkesin siyasi iradesi ve temel hakkı aracılığıyla ifade edilir.





SENİN SESİN SENİN OYUN! #MSK 2025

SENİN SESİN SENİN OYUN! #MSK 2025

SENİN SESİN SENİN OYUN! #MSK 2025



SENIN SESIN SENIN OYUN! MASHI 2025

senator







**KQZ**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

purple bright ideas**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE****SKENAR PËR AKTIVITETET ME TË RINJT NË SHSTATË QENDRAT REGJIONALE TË KOSOVËS****KONCEPTI:**

Videon do ta percjellë një montazhë interaktive ku do të përfshihen pjesë të xhirimeve nga eventet me të rinjtë nga shtatë qendrat regjionale të Kosovës. Në fillim të videos një zë narrative do të tregoj qëllimin e aktivitetit. Ndërsa, përmes lidhjes së fjalive të ndryshme do të formohet një informim i përgjithshëm që thuhet nga vetë informuesit. Pas pjesës së parë informuese të videos, kalojmë në pjesën e dytë që i takon përshtypjeve që të rinjtë do të marrin nga këto aktivitete. Pjesa e fundit i takon fuqisë së slloganit i cili i inkurajon edhe të rinjtë tjerë që të jenë pjesëmarrës në zgjedhje.

SKENARI:

VIDEO	AUDIO	KOHËZGJATJA
<p>Pamje droni nga regjione të ndryshme të Kosovës.</p> <p>Titulli: Informimi I Votuesve të Rinj</p>	<p>Melodia e KQZ-së në prapavijë përgjatë gjithë videos.</p> <p>Narracion(offscreen):</p> <p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes takimeve me të rinjtë në të gjitha komunat e Kosovës....</p>	00:07
<p>Pamje nga sesioni informues në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë. Nga këto sesione shohim interaksion mes zyrtarëve të KQZ-së dhe të rinjve pjesëmarrës.</p>	<p>Narracion(offscreen):</p> <p>... informuan ata për të drejtën e tyre për të votuar, arsyet pse duhet të marrin pjesë në votim, llojet e zgjedhjeve në vendin tonë...</p>	00:10
<p>Pamje nga sesioni informues në Pejë, Prizren, Mitrovicë. Edhe këtu vazhdon interaksioni mes zyrtarëve të KQZ-së dhe të rinjve pjesëmarrës.</p>	<p>Narracion(offscreen):</p> <p>... dhe informata të tjera të rëndësishme që ju mundëson të rinjve të vendit ta kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre si votues për herë të parë.</p>	00:10
<p>Pamje të informuesit në Prishtinë që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj.</p>	<p>Informuesi:</p>	00:04

**KQZ**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

purple bright
ideas

Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.	Çdo qytetar mbi 18 vjet, ose që i mbush 18 vjet në ditën e zgjedhjeve...	
Pamje të informuesit në Pejë që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj. Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.	Informuesi: ...ka të drejtë për të zgjedhë dhe të zgjidhet nëse është shtetas i Republikës së Kosovës...	00:05
Pamje të informuesit në Prizren që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj. Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.		00:06
Pamje të informuesit në Mitrovicë që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj. Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.		00:04
Pamje të informuesit në Gjakovës që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj. Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.	Informuesi: Vota është zgjedhje individuale përmes së cilit shprehet vullneti politik....	00:05
Pamje të informuesit në Ferizaj që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj. Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.	Informuesi: ...dhe e drejtë themelore që gëzon çdo individ mbi 18 vjeç.	00:04
Pamje të informuesit në Gjilan që ju drejtohet pjesëmarrësve të rinj. Plane të afërta të të rinjve që dëgjojnë me vëmendje.	Informuesi:	00:08
Përmes pamjeve, pa zë, shohim edhe pika të tjera të diskutimit dhe interaksion mes të rrënjëve që marrin informatat.		00:08
Një shkëputje grafike ku të rinjtë tjerë jo pjesëmarrës njoftohen se ku duhet të drejtohen për të kuptuar se në cilat qendra të votimit janë caktuar që të votojnë dhe çfarë dokumenti duhet ta kenë me vete kur të votojnë.	Narratori shpjegon se ku duhet të drejtohen për të kuptuar se në cilat qendra të votimit janë caktuar që të votojnë, mundësin e ndërrimit të saj dhe çfarë dokumenti duhet ta kenë me vete kur të votojnë.	00:20
Pamje në plane të mesme të të rinjve që flasin në drejtim të kamerës. Përfshihen edhe pamje të hapësirave të jashtme të disa qyteteve.	Në pika të shkurta flasin për përshtypjet e tyre gjatë aktivitetit dhe çka ata kanë kuptuar nga e drejta e tyre për të votuar.	00:50



KQZ

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

purple bright
ideas

Video përmbillet me të rinjë që e thonë slloganin.	Zëri yt, vota jote!	00:12
Grupi i të rinjve nga një qendër regjionale, një zëri përmbyllin videon me slloganin.	Zëri yt, vota jote!	00:03
Fade out. Packshot: Llogo		00:04
TOTALI I MINUTAZHËS:		02:40



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



INFORMUES PËR VOTUESIT E RINJ

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet e procesit të zgjedhjeve e referendumeve dhe shpall rezultatet e tyre.

KUSH KA TË DREJTË VOTE?

Çdo qytetar mbi 18 vjet, ose që i mbush 18 vjet në ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë me zgjedhë dhe të zgjidhet, nëse është shtetas i Republikës së Kosovës, apo i plotëson kushtet, mbi Shtetësinë, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Votuesi i cili jeton jashtë Kosovës, ka të drejtë të votojë sipas ligjit dhe rregullave të KQZ-së, përmes postës ose në përfaqësi diplomatike.

ÇKA ËSHTË VOTA?

Vota është individuale e shprehur përmes vullnetit politik dhe e drejtë themelore e çdo personi mbi 18 vjeç.

VOTA ËSHTË:

- **Personale** - Zgjedhja i takon vetëm votuesit;
- **E barabartë** - Vota e secilit votues ka vlerën e njëjtë;
- **E lirë** - Votuesi, është plotësisht i lirë në përzgjedhjen e subjektit politik; dhe
- **E fshehtë** - Votuesi voton në mënyrë të fshehtë.

PSE DUHET TË VOTOSH?

- Vota jote, është zëri yt ;
- Ti je ai që vendosë për përfaqësuesit e tu;
- Pjesëmarrja në votime, është tregues i qytetarisë dhe i angazhimit qytetar dhe e përmirëson demokracinë;
- Votimi është forma përmes së cilës ju kërkon llogari atyre që u qeverisin; dhe
- Pjesëmarrja në votim, është një detyrim moral i secilit prej nesh ndaj komunitetit.

ÇFARË LLOJE TË ZGJEDHJEVE MBAHEN NË VENDIN TONË?

- Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës
- Zgjedhje për Kuvendet Komunale
- Zgjedhje për Kryetar të Komunave

Përmes zgjedhjeve për kuvendin e Kosovës e zgjedhim subjektin dhe deputetët e preferuar për formimin e qeverisë.

Përmes zgjedhjeve për kuvendet komunale ne i zgjedhim këshilltarët komunal të komunës tonë.

Përmes zgjedhjeve për kryetar komune ne e zgjedhim kryetarin e komunës tonë.

KUSH GARON PËR ZGJEDHJE?

- Partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur.

SA ËSHTË NUMRI MAKSIMAL I KANDIDATËVE QË ZGJEDHEN?

- Për Kuvendin e Kosovës zgjedhen 120 deputetë, 100 me vota direkte të votuesve dhe 20 janë ulëse të rezervuara për komunitetet jo shumicë.
- Për Kryetar Komune nga të gjithë kandidatët që garojnë ai që merr mbi 50% të votave bëhet kryetar i asaj komune.
- Për Këshilltarë Komunal zgjedhen atë përfaqësues sa ka ulëse asambleja e komunës përkatëse.

KU DUHET TË INFORMOHESH SE NË CILËN QENDËR TË VOTIMIT JE ÇAKTUAR TË VOTOSH?

- Mund të kyçesh përmes QR code:
<https://eomp.kqz-ks.org/sq/PollingCenter/ActualPollingCenter> ose
- Në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tënde.

ORARI KUR MUND TË VOTOSH

Qendrat e votimit hapen në ora 7:00, dhe mbyllen në ora 19:00.

DOKUMENTET ME TË CILAT MUND TË VOTOSH

Për të votuar, mjafton të kesh njërin prej këtyre dokumenteve të lëshuara nga Republika e Kosovës:

- Letërnjoftimin;
- Pasaportën; ose
- Lejen e vozitjes.

SI TË PLOTËSOSH FLETËVOTIMIN?

Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ti mund të votosh vetëm për një Subjekt Politik të renditur në anën e majtë të fletëvotimit, ndërsa në anën e djathtë mund të votosh deri në dhjetë kandidatë nga ai subjekt politik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
IZBBORI ZA SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVO
KOSOVA CUMHURİYETİ MECLİSİ SEÇİMLERİ

1 Shënjoni **VETËM NJË** subjekt politik
Oznaçite **SAMO JEDAN** politički subjekat
SADECE BİR siyasi kuruluđu işaretleyin

2 Shënjoni **DERI NË DHJETË** kandidat
Oznaçite **DO DESET** kandidata
EN FAZLA ON aday işaretleyin

111. DAFINA ZEQRIRI

112.  FC BALLKANI

113.  KF LLAPI

114.  KF MALISHEVA

115.  FC PRISHTINA

116. DISTRIA KRASNIQI

117.  KF DUKAGJINI

118. RITA ORA

119. NORA GJAKOVA

120.  SC GJILANI

121. DUA LIPA

122.  FC FERONIKELI 74

123.  FC DRITA

124.  KF FUSHË KOSOVA

125.  KF LIRA

1	2	3	4
5	6	7	8
9	10	11	12
13	14	15	16
17	18	19	20
21	22	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36
37	38	39	40
41	42	43	44
45	46	47	48
49	50	51	52
53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
81	82	83	84
85	86	87	88
89	90	91	92
93	94	95	96
97	98	99	100
101	102	103	104
105	106	107	108
109	110		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64. 2 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.04.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Raportit për Realizimin e Planit të Punës së KQZ për vitin 2023

- I. Miratohet Raporti i Realizimit të Planit të Punës së KQZ për vitin 2023.
- II. Raporti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I REALIZIMIT TË
PLANIT TË PUNËS SË KQZ 2023
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2023**

Shkurt, 2024

Përmbajtja

1. HYRJE.....	2
2. REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË PLANIT TË PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR, 2023	3
2.1. QËNDRUESHMERIA DHE FUQIZIMI INSTITUCIONAL	3
2.2. KORNIZA LIGJORE.....	21
2.3. GJITHËPËRFSHIRJA DHE PJESMARRJA NË ZGJEDHJE.....	25
2.4. INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA	31
2.5. BASIKËPUNIMI DHE TRANSPARENCA	33
3. PROGRESI NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS.....	40

1. HYRJE

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), në pajtim me obligimet që dalin nga Plani vjetor i punës së Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për vitin 2023, i rishikuar në KQZ në mbledhjen nr.21/2023 (vendimi nr. 01-803-2023), të datës 12.07.2023, i plotësuar në raportimin tre mujor T1 (vendimi nr. 01-623-2023) të datës 11.05.2023, i plotësuar në raportimin tre mujor T2 (vendimi nr.01-849-2023) të datës 25.07.2023, i plotësuar në raportimin tre mujor T3 (vendimi nr. 01-1159-2023) të datës 14.11.2023, njoftim me vlerësimin paraprak të zbatimit të planit të punës së KQZ për vitin 2023 - periudha janar – nëntor 2023, në mbledhjen nr.33 me datë 06 dhjetor 2023 si dhe aktivitetet e miratuara nga KQZ për periudhën e raportimit T4, ka përgatitur raportin përfundimtar të realizimit të planit të punës së KQZ për periudhën janar – dhjetor 2023.

Raporti pasqyron një përmbledhje të përgjithshme mbi aktivitetet dhe angazhimet e SKQZ, në përmbushjen e Planit të punës. Raporti, në mënyrë të detajuar, e paraqet punën e kryer për secilin aktivitet të paraparë të realizohet në këtë periudhë si dhe aktivitetet që nuk kanë mundur të realizohen. Në planin e punës së KQZ për vitin 2023 kanë qenë gjithsej 59 aktivitete të ndarë në pesë (5) shtylla strategjike.

- *Shtylla strategjike/ Qëndrueshmëria dhe Fuqizimi Institucional: njëzet e shtatë (27) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Korniza Ligjore: tri (3) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Gjithëpërfshirja dhe Pjesëmarrja në Zgjedhje: dhjetë (10) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Inovacioni dhe Teknologjia: gjashtë (6) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Bashkëpunimi dhe Transparenca: trembëdhjetë (13) aktivitete*

Raporti pasqyron përshkrimin e aktiviteteve dhe realizimin e Planit të Punës së KQZ 2023 për periudhën janar – dhjetor 2023.

2. REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË PLANIT TË PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR, 2023

2.1. QËNDRUESHMERIA DHE FUQIZIMI INSTITUCIONAL

Aktiviteti 1:	Miratimi i Planit Strategjik të KQZ, 2023 - 2026
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Sipas vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar - qershor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 03 qershor 2022 në Mbledhjen nr. 17-2022 (vendimi nr. 01-756-2022) ka marrë vendim për formimin e grupit punes për hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së. Grupi punues ka vazhduar punës për finalizimin e Planit Strategjik duke mbajtur shumë takime të grupit punues dhe nëngrupeve punuese dhe mëse 3 punëtori deri në finalizimin e planit strategjik. Pas finalizimit të Planit Strategjik të KQZ për periudhën 2023-2026, KQZ në mbledhjen nr.20/2023, dat.26.06.2023, ka miratuar Planit Strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2023-2026 (Vendimi nr. 01/766-2023, dat.26.06.2023). Aktiviteti është realizuar brenda afatit të planifikuar me planin e punës 2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 2:	Hartimi i Strategjisë për trajnimin e Trupave Menaxhuese Zgjedhore
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Udhëheqësi i Divizionit i Trajnimit
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar - Qershor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Divizioni i trajnimit ka hartuar draftin e Strategjisë, duke analizuar të gjitha raportet e brendshme të akterëve tjerë pjesëmarrës në proceset zgjedhore, si dhe ka bërë harmonizimin e të gjitha raporteve dhe analizave, të cilat kane shërbyer si të dhëna/gjetura determinuese për përpilimin e strategjisë në fjalë.

Strategjia e trajnimit të Trupave menaxhuese të zgjedhjeve ka për qëllim, arritjen e standardeve të avancuara në fushën e trajnimeve, duke përpiluar dhe hartuar kurikula trajnimi me modalitete koherente dhe lehtë të qasshme për të gjithë akteret pjesëmarrës në infrastrukturën organizative të proceseve zgjedhore. Nga aplikimi i këtyre metodologjive, synohet ndërtimi i një mekanizmi funksional, cilësorë dhe i qëndrueshëm për Trupat Menaxhuese të Zgjedhjeve (TMZ), të cilët operojnë përmes tri procedurave kryesore që e përshkojnë ditën e zgjedhjeve: Votim dhe numërim, VPNRV dhe pranim-dorëzimi i materialeve zgjedhore nga Këshillat e Vendvotimeve (KVV) tek Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ).

Dokumenti është prezantuar në menaxhment, pastaj është trajtuar në mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Zgjedhore (KOZ), nr.22/2023. Pas shqyrtimit në KOZ, u morr vendim për ndryshimin e emërimit të dokumentit nga Strategjia në “**Dokumenti orientues i trajnimit për TMZ**”. Si i tillë Dokumenti u miratua në KOZ për të vazhduar për miratim edhe në KQZ. Në mbledhjen nr. 25 të datës 31.08.2023 dokumenti në fjale u miratua edhe në KQZ.

Si rrjedhojë e Dokumentit të miratuar, pason realizimi i objektivave të parashtruara të cilat janë në përpunim e sipër duke u bazuar në hartimin e rregullave zgjedhore në baze të ndryshimeve që ka pësuar L.ZP.

Në kuadër të një nga objektivat që kanë të bëjnë me harmonizimin e procedurave të trajnimit konform ndryshimeve në rregullat zgjedhore, div. i trajnimit në bashkëpunim me njësitë tjera ka zhvilluar **Projektin e simulimit të procesit zgjedhor**, me qëllim të identifikimit të fushave dhe vlerësimin e impaktit që do ta kenë rregullat e reja zgjedhore në procedurat e ditës së zgjedhjeve. Simulimi i procesit zgjedhore u zhvillua me datën: 13.09.2023. Për më tepër për këtë aktivitet është përgatitur raporti i cili përmban gjithë mbarëvajtjen e procesit, të gjeturat dhe rekomandimet që dolën nga pjesëmarrësit.

Në vazhdim të objektivave të cilat janë në kuadër të dokumentit të miratuar, divizioni i trajnimit është duke bërë edhe përgatitjen e procedura të cilat do të jen pjesë e platformës digjitale.

Me vendim të KQZ aktiviteti i është ndryshuar emri nga **Hartimi i Strategjisë për trajnimin e Trupave Menaxhuese Zgjedhore në dokumentit orientues për trajnimin e trupave menaxhuese të zgjedhjeve**

Aktiviteti ka qenë i planifikuar të realizohet në muajin qershor 2023, mirëpo nga qershori deri në gusht me kërkesë të KOZ është kthyer për plotësim tri herë dhe është miratuar me datë 31 gusht 2023

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 3:	Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për adresim të rekomandimeve nga raportet e vëzhguesve të zgjedhjeve lokale 2021
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i DOZ
Periudha e realizimit:	Janar – Dhjetor 2023
Tjera:	/

Raporti përmban informatat e adresimit të rekomandimeve nga Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian nga zgjedhjet lokale të vitit 2021.

KQZ ka qenë pjesë e komisionit për reformën zgjedhore dhe ka dërguar rekomandimet, si dhe me rishikimin e legjislacionit sekondar të (Rregullave të Zgjedhjeve), ka adresuar rekomandimet e dhëna në raportin nga Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian për zgjedhjet lokale të vitit 2021.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 4: **Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm 2024 – 2026 dhe Plani i Veprimit 2024**

Statusi: Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e: NjAB
Periudha e realizimit: Dhjetor 2023
Tjera: /

Aktiviteti është përfunduar. Plani Strategjik i AB 2024- 2026 dhe Plani Vjetor i AB 2024 janë përgatitur, janë shqyrtuar në KA dhe aprovuar. Të njëjtit janë dorëzuar në Njesinë Qendrore Harmonizuese për AB në MFFT me datë 31.12.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti :5 **Pjesëmarrja e barabartë gjinore në trupat menaxhuese të zgjedhjeve**

Statusi: Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e: Grupi Punues i SKQZ/ZRPPC
Periudha e realizimit: Maj – Tetor 2023
Tjera: /

Bazuar në Planin e Punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2023, grupi punës ka përgatitur draft projektin “Pjesëmarrja e barabartë gjinore në Trupat Menaxhuese të zgjedhjeve”, i cili ka për qëllim promovimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në trupat menaxhues të zgjedhjeve, fuqizimin e kapaciteteve institucionale për promovimin dhe punën drejt përfaqësimit të barabartë gjinor dhe fuqizimit të femrave në procese zgjedhore.

Draft projekti është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ-it nr. 26/202, me datë 22.09.2023. Nga anëtarët e KOZ-it, është kërkuar që fillimisht të përgatitet raporti “Analizë e përfaqësimit të grup moshave dhe gjinisë në trupat zgjedhor për zgjedhjet e vitit 2021”, pas miratimit të kësaj analize, ky projekt të sjellët për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e KOZ-it.

Projekti është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ nr. 27/2022, me datë 19.10.2023. KQZ në mbledhjen nr. 29/2023 me datën 31.10.2023, ka miratuar projektin “Pjesëmarrja e barabartë gjinore në trupat menaxhuese të zgjedhjeve”, me Vendim nr. 01/1099-2023.

KQZ, më 15 nëntor 2023, në nivel qendror ka mbajtur tryezën me temën “Pjesëmarrja e barabartë gjinore në Trupat Menaxhuese të zgjedhjeve”, në “Swiss Diamond Hotel” Prishtinë.

Në këtë tryezë panelistë ishin z. Kreshnik Radoniqi - Kryetar i KQZ, Ambasadori Michael Davenport - Shefi i OSBE-së në Kosovë dhe znj. Edi Gusia - Ud.Drejtoresh e Agjencisë për Barazi Gjinore. Po ashtu në këtë tryezë morrën pjesë, deputetja e Kuvendit të Lëvizjes Vetëvendosje, përfaqësuese e subjektit politik RI, përfaqësuesi i PZAP-së, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat. Deputet e kuvendit të subjekteve

politike të tjera edhe pse kanë konfirmuar pjesëmarrjen, nuk kanë marrë pjesë në këtë tryezë, Përfaqësuesit e subjekteve politike, nuk ju kanë përgjigjur ftesës së KQZ-së, për pjesëmarrje në këtë tryezë.

Pas organizimit të tryezës në nivel qendror, është vazhduar me organizimin e tryezave në nivel lokal në qendrat regjionale si në vijim:

Tryeza në regjionin e Prishtinës është mbajtur, më 17 nëntor 2023;

Tryeza në regjionin e Gjilanit, tryeza është mbajtur, më 20 nëntor 2023;

Tryeza në regjionin e Pejës, tryeza është mbajtur, më 22 nëntor 2023;

Tryeza në regjionin e Gjakovës, tryeza është mbajtur, më 24 nëntor 2023;

Tryeza në regjionin e Prizrenit, tryeza është mbajtur më 04.12.2023;

Tryeza në regjionin e Ferizajit, tryeza është mbajtur më 08.12.2023; dhe

Tryeza në regjionin e Mitrovicës së Jugut, tryeza është mbajtur më 11.12.2023.

Në këto tryeza morën pjesë përfaqësues të Sekretariatit, OSBE-së, gra deputete që përfaqësojnë subjektet politike në Kuvendet Komunale, zyrtaret komunale për barazi gjinore, dhe organizata e shoqërisë civile lokale.

Aktiviteti ka qenë i planifikuar të realizohet në muajin tetor 2023, mirëpo ka pasur vonesa në miratimin e tij.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Kategoria:	Digjitalizimi i proceseve të trajnimit
Statusi:	Nuk është realizuar Realizimi i këtij procesi parashihet që të zhvillohet në vitin 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Valbona Kida
Periudha e realizimit:	Korrik - Nëntor 2023
Tjera:	/

Kamisioni Qendror i Zgjedhjeve është në procesin e plotësimit ndryshimit të rregullave zgjedhore dhe digjitalizimi i proceseve të trajnimit varet nga ndryshimet procedurale që rregullat zgjedhore i parashohin andaj të njëjtat ndryshime do të inkorporohen dhe të aplikohen në platformën digjitale. Procesi i digjitalizimit të trajnimit si platformë do të përkrahet nga OSBE dhe realizimi i këtij procesi parashihet që të zhvillohet në vitin 2024.

Modulet të cilat do të nënshtrohen procesit të digjitalizimit janë:

- Procedurat e Votimit dhe numërimit në VV;
- Procedurat e VPNV;
- Procedurat e numërimit në QKN dhe
- Procedurat pranimit-dorëzimit në këtë proces, KVV-QKN-QNR.
- Procedurat e QNR

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 7:	Hartimi i Planit te buxhetit 2024 - 2026; dhe Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2024 - 2026
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DAP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Mars - Dhjetor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Planifikimi i Buxhetit është cikël buxhetor ne vitin fiskal. Për KQZ, ky aktivitet ka filluar ne mars me hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026.

Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve (MFPT) ka lëshuar Instruksionin për përgatitjen e KSH-it për vitet 2024-2026, në të cilën janë dhënë kriteret e përgjithshme për përgatitjen e këtij dokumenti. Udhëheqësve të departamenteve dhe të divizioneve u është drejtuar me shkresë për hartimin e kërkesave buxhetore dhe përfshirjes së tyre në KASH. Pasi janë pranuar kërkesat buxhetore nga të gjitha njësitë, janë përpunuar të gjitha të dhënat dhe kërkesat dhe është hartuar dokumenti i KASH, 2024-2026, i cili është shqyrtuar dhe aprovuar nga menaxhmenti.

Në takimin e Këshillit për Buxhet dhe Financa (KBF) të mbajtur më 17.03.2023, është shqyrtuar dhe miratuar KASH për vitet 2024-2026, dhe i është propozuar KQZ, për shqyrtim. KQZ-janë takimin e mbajtur më 21.03.2023, ka shqyrtuar dhe miratuar KASSH për vitet 2024-2026, dhe brenda afatit e ka proceduar në MFPT. Vendimi i KQZ, nr. 01-305-2023, dat. 21.03.2023. MFPT në muajin maj 2023, ka lëshuar Qarkoren e parë buxhetore 2024/01 në të cilën janë caktuar kufijtë dhe janë dhënë informata të mjaftuara për hartimin e Propozim buxhetit.

KQZ, duke u bazuar në udhëzimet e dhëna në Qarkoren 2024/01 ka përgatitur propozim Buxhetin për periudhën 2024-2026. Përgatitjes dhe hartimit të këtij dokumenti i ka parapri përcaktimi i objektivave të institucionit, identifikimi i nevojave dhe analiza e kërkesave nga secila njësi kërkuese buxhetore. Pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore për vitet 2024-2026 nga MFPT, janë harmonizuar të gjitha kërkesat e njërive të SKQZ me Ligjin e ri të zgjedhjeve të përgjithshme. Ne lidhje me këtë janë mbajtur takime nga dy këshillat: KBF dhe KOZ.

KQZ, në takimin e mbajtur me datën 12.07.2023, ka shqyrtuar dhe Planin e Buxhetit për Qarkoren e parë buxhetore 2024/01, e njëjta është dërguar ne Ministrinë e Financave së bashku me kërkesat shtesë dhe me planet e projekteve. Vendimi i KQZ, nr. 01-802-2023, dat. 12.07.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 8:	Raportimi i obligimeve të papaguara
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DAP
Periudha e realizimit:	Janar – Dhjetor 2023
Tjera:	/

Raportimi i obligimeve të pa paguara është obligim ligjor dhe duhet të raportohet për çdo muaj në MFPT, përkatësisht në Departamentin e Thesarit. Raportimet bëhen duke u bazuar në Rregullën financiare 02/2013 të MF dhe Qarkoren nr. 84, dat.31.03.2021. Raportimi i obligimeve të pa paguara duhet të bëhet për çdo muaj. Pra, organizatat buxhetore janë të obliguara që deri më datën 15 të raportojnë çdo muaj faturat e pa paguara për muajin paraprak.

Nga KQZ, në formularët standard të Thesarit janë raportuar faturat, si dhe obligimet e pa paguara:

- janar- faturat dhe obligimet e pa paguara nga dhjetor 2022
- shkurt- faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit janar 2023
- mars - faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit shkurt 2023
- prill - faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit mars 2023
- maj - faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit prill 2023
- qershor - faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit maj 2023
- korrik- faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit qershor 2023
- nëntor- faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit tetor 2023
- dhjetor- faturat dhe obligimet e pa paguara të muajit nëntor 2023

Ky proces duhet të vazhdojë gjatë tërë vitit fiskal dhe për faturat e mbetura nga muaji paraprak do të realizohet në muajin pasues.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 9:	Pajtueshmëria e regjistrave kontabël në SIMFK dhe regjistrave kontabël të KQZ
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DAP
Periudha e realizimit:	Janar – Dhjetor 2023
Tjera:	/

Raportimi me pajtueshmërinë e regjistrave kontabël në SIMFK dhe regjistrave kontabël të KQZ, është planifikuar të raportohet për çdo muaj të vitit fiskal. Ky proces ka për qëllim konfirmimin e saktësisë përkatësisht të buxhetit, shpenzimeve dhe të hyrave mes Freebalancit dhe Librit financiar të KQZ. Raportimi bëhet për muajin paraprak, pas mbylljes së periudhës, pra në javën e parë të muajit vijues.

KQZ, nëpërmjet të këtij procesi konfirmon se regjistrat kontabël në SIMFK janë të sakta dhe përputhen me dokumentacionin financiar dhe legjislacionin.

Deri më tani janë zbatuar procedurat dhe është arritur pajtueshmëria e shpenzimeve nëpërmjet të regjistrave kontabël të SIMFK dhe regjistrave kontabël të KQZ dhe është raportuar në Departamentin e Thesarit pas mbylljes së periudhës për secilin muaj.

Raportimi dhe barazimi është bërë në:

- janar- për periudhën janar-dhjetor 2022
- shkurt për periudhën 1 janar-31 janar 2023
- mars për periudhën 1 janar-28 shkurt 2023
- prill për periudhën 1 janar-31 mars 2023
- maj për periudhën 1 janar-30 prill 2023
- qershor për periudhën 1 janar-31 maj 2023
- korrik për periudhën 1 janar-30 qershor 2023
- gusht për periudhën 1 janar-31 korrik 2023
- shtator për periudhën 1 janar-31 gusht 2023
- tetor për periudhën 1 janar-30 shtator 2023
- nëntor për periudhën 1 janar-31 tetor 2023
- dhjetor për periudhën 1 janar-30 nëntor 2023

Ky proces do të vazhdojë deri në përfundimin e vitit fiskal dhe pajtueshmëria në regjistrat kontabël nga muaji paraprak do të realizohet në muajin pasues.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 10:	Raporti vjetor financiar i KQZ për vitin 2022; dhe Raporti vjetor i punës i KQZ për vitin 2022 për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DAP & Zëdhënësi i KQZ
Periudha e realizimit:	Janar - Prill 2023
Tjera:	/

Raportit vjetor financiar i KQZ, është shqyrtuar në mbledhjen e KBF nr.02/2023, më datën 27.01.2023, dhe KQZ, në mbledhjen , nr.03/2023, të dat.27.01.2023, ka miratuar raportin vjetor financiar të KQZ, vitin 2022.Vendimi nr. 01-98/2023, datë 27.01.2023. Raporti është dërguar në MFPT.

Raportit vjetor i punës së KQZ, për vitin 2022, për Kuvendin e Republikës së Kosovës është përfunduar në muajin prill 2023. SKQZ, ka grumbulluar të dhënat nga raportet vjetore të departamenteve dhe drafti i raportit vjetor të punës së KQZ, për vitin 2022, është shqyrtuar në mbledhjen KOZ, nr.01/2023, dat.25.04.2023, dhe i njëjti është miratuar nga KQZ në mbledhjen nr.15/2023, dat.28.04.2023. Vendimi nr.01-577/2023, datë 28.04.2023. Në këtë raport, si aneks janë bashkëngjitur edhe raportit vjetor financiar i KQZ, për vitin 2022. Raporti, është dërguar në Kuvend të Kosovës më datën 28.04.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 11:	Raporti financiar për Fondin e Subjekteve Politike 2022 për Kuvendin e Kosovës
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Qershor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Neni 6 i Ligjit nr. 04/L-058. e obligon KQZ. që të përgatit raport vjetor për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi për Kuvend të Kosovës. Në lidhje me këtë aktivitet. KQZ. në mbledhjen nr. 14/ 2023. datë 24.04.2023. ka miratuar Raportin vjetor të punës për Kuvendin e Kosovës 2022. që përmban aktivitete e realizuara nga KQZ. për vitin 2022. Në kuadër të këtij raporti. në faqen numër 33 janë përfshirë informatat për Subvencionet dhe transferet për vitin 2022.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 12:	Raportimi tre mujor i shpenzimeve të buxhetit
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DAP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Prill, Korrik, Tetor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Pas përfundimit të çdo periudhe tremujore, nga Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes (DAP), përgatit raportin e shpenzimeve tremujore të buxhetit.

Raporti i shpenzimeve të buxhetit, për periudhën janar-mars 2023, është shqyrtuar në KBF në mbledhjen nr. 06/2023, dat.11.05.2023. KQZ, në mbledhjen nr.17/2023, dat.11.05.2023, ka miratuar, Raporti i shpenzimeve të buxhetit, për periudhën janar-mars 2023. Vendimi nr. 01/622-2023, datë 11.05.2023.

Raporti i shpenzimeve të buxhetit për përudhën janar-qershor 2023 është shqyrtuar në KBF në mbledhjen nr. 09/2023, datën 24.07.2023. KQZ në mbledhjen nr.23/2023 me datën 25.07.2023 ka miratuar Raportin e shpenzimeve të buxhetit për periudhën janar-qershor 2023. Me vendimin nr. 01/847-2023 të datës 25.07.2023.

Raporti i shpenzimeve të buxhetit për përudhën janar-shtator 2023 është përgatitur dhe është në fazën për tu shqyrtuar nga KBF.

Raporti i shpenzimeve të buxhetit për përudhën janar-shtator 2023 është shqyrtuar në KBF në mbledhjen nr. 13/2023, datën 07.11.2023. KQZ në mbledhjen nr.30/2023 me datën 14.11.2023 ka miratuar Raportin e Shpenzimeve të Buxhetit për periudhën janar-shtator 2023. Me vendimin nr. 01/1162-2023 të datës 14.11.2023.

Raportimi i periudhës janar – dhjetor 2023 (I4) do të bëhet në muajin janar 2024.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 13:	Tjetërsimi i pasurive jo financiare të KQZ, nëpërmjet shitjes dhe donimit	
<i>Statusi:</i>	Pjesërisht i realizuar	Realizimi i këtij procesi parashihet që të zhvillohet në vitin 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DAP / Drejtor i Prokurimit	
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt-Gusht 2023	
<i>Tjera:</i>	/	

Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ, me datën 24.01.2023, ka nxjerr vendimin nr.02/69-2023, për themelimin e komisionit për vlerësimin e pasurive jo financiare në KQZ. Komisioni në përputhje me Udhëzimin Administrativ 02/2022, për menaxhimin e pasurive jo financiare të KQZ, fillimisht ka analizuar raportin nr.897/2022, dat.18.07.2022, për hartimin e specifikave për tjetërsim të pasurisë, dhe rekomandimet e Auditorit të jashtëm.

Komisioni ka përfunduar fazën e parë të aktivitetit në Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) me vlerësimin e pasurive jo financiare që është në pronësi të KQZ, dhe ku do të vazhdohet edhe me objektin KQZ. Komisioni ka përfunduar hartimin e raportit me asetet që do të shiten dhe është proceduar për shitje. Nga Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve (MFPT), bazuar në Udhëzimin Administrativ 02/2022, për pasurinë jo financiare që janë të klasifikuara si kapitale, nevojitetë paraprakisht leja nga MFPT për tu tjetërsuar. KQZ ka pranuar lejën për tjetërsimin e artikujve që janë konsideruar si kapitale dhe është në fazën e selektimit (ekspozimit) të artikujve para se të shpallet procedura e prokurimit përmes ankandit (shitjes).

Pasuria jo financiare e cila sipas vendimit të KQZ të vitit 2022 do të tjetërsohet përmes shitjes është në fazën para zhvillimit të procedurat e prokurimit përmes ankandit. Paraprakisht nevojitet artikujt të jenë të ekspozuar dhe klasifikuar dhe më pastaj të bëhet shpallja e procedurave të ankandit. Me datë 13 shtator në QNR është zhvilluar procesi i simulimit të procesit zgjedhor dhe po ajo hapësirë në QNR do të përdoret për ekspozimin e artikujve që do të tjetërsohen përmes shitjes. Sekretariati është në fazën e selektimit të artikujve për ekspozim.

KQZ për vitin 2023 ka bërë vlerësimin e pasurisë jo financiare për vitin 2023, për të cilin është raportuar në KEF me datën 07.11.2023 në mbledhjen e mbajtur me nr 13/2023. KQZ në mbledhjen nr.30/2023 me datën 14.11.2023 ka miratuar Raportin e për vlerësimin e pasurisë jo financiare për vitin 2023. Me vendimin nr. 01/1161-2023 të datës 14.11.2023. Kryeshefi Ekzekutiv me vendimin nr 02/1149-2023 të datës 14/11/2023, ka formuar komisionin për caktimin e vlerës minimale të artikujve për pasuritë jo financiare të cilat do të dalin në ankand.

Statusi i aktivitetit është: pjesërisht i realizuar

Aktiviteti 14:	Miratimi i Planit të rekrutimit të stafit të SKQZ
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DAP
Periudha e realizimit:	Janar 2022
Tjera:	/

SKQZ, ka hartuar planin e rekrutimit të personelit në KQZ, për vitin 2023, duke identifikuar të gjitha pozitat e lira, dhe arsyet e pozitave vakante të paraqitura në kalendarin e planit të rekrutimit për vitin 2023, në mënyrë që të fillohet me procedurat e rekrutimit në bazë të Rregullores nr.01/2017, Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës në SKQZ, Rregulloren nr. 03/2017, Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në SKQZ.

Plani i rekrutimit është shqyrtuar në mbledhjen e Këshilli të Personelit (KP) nr. 01/2023, datën 27.01.2023. KQZ, në mbledhjen nr.03/2023, dat.27.01.2023, ka miratuar planin e rekrutimit për vitin 2023. Vendimi nr. 01/95-2023, dat.27.01.2023.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 27 janar 2023, me vendimin nr. 01-95-2023 ka miratuar planin e rekrutimit për vitin 2023. Ne planin e rekrutimit për vitin 2023, ishin planifikuar të shpallen gjithsejtë 12 (dymbëdhjetë) pozita:

1. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut;
2. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Leposaviç;
3. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zubin Potok;
4. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zveçan;
5. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë;
6. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan;
7. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë;
8. Zyrtar i Lartë për Financa – Zotues;
9. Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Perkrahtjes
10. Udheheqës i Divizionit për Sherbimin Votues;
11. Udheheqës i Njësisë së QNR-së;
12. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Gjilan.

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me qëllim të zbatimit të këtij plani, ka proceduar me shpalljen e konkursit me datën 30 janar 2023, për gjashtë (6) pozita:

1. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut;
2. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Leposaviç;
3. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zubin Potok;
4. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zveçan;
5. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë;
6. Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan;

Për pozitat me numër rendor 1 deri 4, konkursi i shpallur në datën e lartshënuar, në mungesë të numrit të vogël të aplikanteve, konkursi ka dështuar. Me datën 24 shkurt 2023, ky konkurs është rishpallur dhe, edhehëna rishpallja numri i aplikantëve ka qenë tejet i vogël. Komisioni përzgjedhës, nuk ka mundur të listoj në rreth të ngushtë asnjë kandidat për arsye të mos plotësimit të kriterëve të konkursit dhe kjo ka përbërë shkak për anulimin e konkursit.

5. Pozita e ZLKZ në Mamushë Kjo procedurë ka përfunduar, kandidati i përzgjedhur ka nënshkruar aktin e emërimit.

6. Pozita e ZLKZ në Lipjan, pas rikthimit të procedurës në rishqyrtim sipas vendimit të KPMSHCK-se, kjo procedurë është në proces të ankesave.

7. Pozita e ZLKZ në Malishevë, Kjo procedurë ka përfunduar, kandidati i përzgjedhur ka nënshkruar aktin e emërimit.

8. Zyrtarit të Lartë për Financa / Zotues, kjo pozite ishte anuluar pas mbajtjes së testit me shkrim, dhe pas ushtrimit të ankesave nga kandidat, KPMSHCK, ka obliguar Kryeshef-in që të vazhdojë me procedurën aty ka mbetur gjithë që edhe ka ndodhur, është shpallur kandidati i suksesshëm, dhe tani procedura është në fazën e ankesave në KPMSHCK.

Pozitat tjera, të miratuara për shpallje sipas planit të rekrutimit për vitin 2023, janë stopuar, për arsye të harmonizimit të rregulloreve të brendshme me legjislacionin aktual në fuqi.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 15:	Ngritja e kapaciteteve të stafit të KQZ
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DOZ/Drejtor i DAP
Periudha e realizimit:	Janar-Dhjetor 2023
Tjera:	/

Plan i trajnimit, ka për qëllim ndërtimin e një mekanizmi funksional, cilësorë dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të cilat zhvillohen në institucionin tone, gjithëashtu edhe arritjen e standardeve krahas zhvillimeve aktuale në trendet digjitale globale të proceseve zgjedhore dhe në administratën publike. Përkushtimi në realizimin e këtij qëllimi, jep mundësi të reja profesionale, jo vetëm për stafin e KQZ, por edhe bartjen e këtyre njohurive tek të gjithë akteret tjerë pjesëmarrës të angazhuar në proceset zgjedhore.

Faza e parë e këtij aktiviteti, ka filluar me hartimin e Draft konceptit për aktivitete e identifikimit të nevojave të trajnimit i cili është shqyrtuar nga grupi punues dhe KE. Koncepti i hartuar përmbante të gjithë hapat për realizimin e këtij aktiviteti.

Pas dakordimit për konceptin, grupi punues ka filluar me aktivitetet pasuese që janë:

- Eshte bere shqyrtimi dhe dakordimi per pyetesoret. Me pas, pyetesoret jane derguar tek zyrtaret nga data: **08.02-13.02.2023**. Ky proces eshte zhvilluar ne forme digjitale, me dergimin e puetesoreve dhe gjenerimin e pergjigjeve perkatese.
- Nga data **13.02-28.02.2023** eshte bere shqyrtimi i pergjigjeve dhe klasifikimi i tyre ne fushat perkatese per te pasuar me procesin e intervistave me secilin zyrtar ne veçanti.
- Nga data **27.02-01.03.2023** jane zhvilluar intervistat me te gjithë zyrtaret.
- Raporti i analizës ka përfunduar me 30.03.2023 duke u plotësuar edhe me databazen e trajnimeve te ndjekura nga zyrtaret e sekretariatit i cili ka përfunduar me datën: **16.06.2023**.

Kjo analize është përmbledhur në një raport përfundimtare me të dhënat e evidentuara, te gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e dala ne baze te te gjeturave.

Kjo analize është përmbledhur në një raport përfundimtare me të dhënat e evidentuara, te gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e dala ne baze te te gjeturave.

Raporti i analizës është prezantuar ne mbledhjen e këshillit per personel te datës: **23.11.2023**.

Ndër të tjerash, ne kete mbledhje, analiza u shqyrtua dhe miratua ne parim, por mbetet te plotësohet databaza me trajnimet e ndjekura te zyrtareve te SKQZ-se. Ky aktivitet në muajin dhjetor 2023 konsiderohet i plotësuar, por duhet pritur edhe trajnimet e mundshme që mund të ndodhin gjatë muajit dhjetor 2023 dhe të përfshihen në bazën e të dhënave për trajnim.

Stafi kanë ndjekur trajnime për duke u bazuar edhe në raportin për vlerësimin e nevojave për trajnim.

Ky aktivitet duhet të zhvillohet përsëri në vitin 2024 për shkak të miratimit të rregulloreve të brendshme si dhe duke përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnim të ZRCKFSP.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 16:	Punëtori në mes zyrtarëve komunal të zgjedhjeve dhe KQZ, për planin e punës së KQZ për vitin 2023 dhe zbatimin e tij
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DKT-së
Periudha e realizimit:	Shkurt- Nëntor 2023
Tjera:	/

Pjesa e parë e këtij aktiviteti e mbështetur nga OSBE, është realizuar më 09.03.2023, ku kanë marrë pjesë anëtarët e KQZ, stafi i SKQZ, ZE KKZ dhe përfaqësuesit e OSBE. Në këtë punëtori janë trajtuar temat: Prezantimi i planit të punës të KQZ, për vitin 2023, dhe zbatimi i ti, Njoftim për ZE KKZ, lidhur me Qendrat e Votimit (QV) 2023 dhe Njoftim lidhur me Planin Strategjik të KQZ, 2023-2026.

Agjenda, Projekti dhe temat të cilat janë trajtuar në punëtorin e parë janë shqyrtuar në mbledhjen e KOZ, nr.06/2023, të datës 24.02.2023, dhe miratuar në mbledhjen e KQZ,

nr.05/2023, dat.01.03.2023. Vendimi i KQZ, nr. 01-220/2023, dat.01.03.2023. Në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë të mbahet edhe një punëtori, e cila gjithashtu do të përkrahët nga OSBE.

Takimi i dytë i këtij aktiviteti sipas planifikimeve të parapara me Planin e Punës së KQZ-së është realizuar në tre mujorin e fundit të viti 2023 me saktësisht 1-3 nëntor 2023. DKT në kohën e paraparë ka proceduar agjendën dhe planifikimin për mbajtjen e punëtorisë në të cilën kanë qenë pjesëmarrës KQZ dhe Sekretariati përfshirë gjithë Zyrtarët Ekzekutiv të KKZ.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 17:	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2023
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i Prokurimit
Periudha e realizimit:	Janar 2023
Tjera:	/

Plani i prokurimit, është prezantuar për shqyrtim në mbledhjen KBF, nr.01/2023, me datën 19.01.2023. KBF, ka rekomanduar planin për miratim në KQZ. Ky aktivitet është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, nr. 02/2023, të datës 19.01.2023. Vendimi i KQZ, nr. 01-57/2023, dat.19.01.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 18:	Dorëzimi i raportit të kontratave të lidhura për vitin 2022
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i Prokurimit
Periudha e realizimit:	Shkurt 2023
Tjera:	/

Bazuar në nenet nenit 87.2.12 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Raporti Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike nga KQZ në vitin 2022, më datën 09.02.2023, është dërguar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik ashtu siç përcaktohet me Ligji i Prokurimit Publik (LPP).

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 19:	Raport për implementimin e planit të prokurimit për vitin 2023 (raportet çdo tre mujor)
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i Prokurimit
<i>Periudha e realizimit:</i>	Prill, Korrik, Tetor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Për periudhën janar-shtator 2023 aktivitetet e zhvilluara të prokurimit janë:

- njëzet e shtatë (27) aktivitete të prokurimit,
- janë shpërblyer me kontratë 25 aktivitete të prokurimit,
- 15 kontrata të nënshkruara kanë qenë të planifikuara në planin e prokurimit,
- 10 kontrata të nënshkruara nuk kanë qenë të planifikuara në planin e prokurimit,
- janë zhvilluar procedurat për dy (2) aktivitete të prokurimit dhe nuk ka pas ofertues,
- Në dy aktivitete të prokurimit kontratat janë nënshkruar nga AQP.

Nuk janë zhvilluar procedurat për tetë (8) aktivitete të prokurimit.

Një aktivitet është zhvilluar konkurs publik (Melodia e KQZ).

Prokurimit në raportimin janar – dhjetor 2023 ka raportuar për kontratat e lidhura dhe aktivitetet e prokurimit që nuk janë realizuar për vitin 2023

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 20:	Hartimi i planit preliminar të prokurimit për vitin 2024 (30 ditë para përfundimit të vitit fiskal - nëntor)
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i Prokurimit
<i>Periudha e realizimit:</i>	Nëntor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për prokurimin publik Planifikimi paraprak i prokurimit do të përgatitet nga secili Autoritet Kontraktues. Në rast të autoritetit publik ose ndërmarrjes publike, Autoriteti Kontraktues në fjalë do t'i dorëzojë Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues, këtu e tutje "ZKA" me shkrim Planifikimin paraprak të Prokurimit. Planifikimi Paraprak i Prokurimit do t'i dorëzohet ZKA-së jo më pak se 30 ditë para fillimit të vitit fiskal - që do të thotë jo më vonë se 1 Dhjetor të secilit vit.

Planifikimi paraprak i prokurimit përfshin periudhën kohore prej 12 muaj dhe është proces i mbledhjes së të dhënave mbi nevojat e autoritetit kontraktues të përmbledhura në dokument me shkrim i cili duhet të përmbajë të gjitha informacionet siç kërkohen në Formularin Standard B01 "Planifikimi i Prokurimit".

Draftimi dhe hartimi i planit preliminar të prokurimit për vitin 2024 është realizuar me datë 30 nëntor 2023. Zyrtarët në draftimin e aktiviteteve të prokurimit kanë pasur parasysh Planin e Buxhetit për vitin 2024.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Organizimi i takimeve të KQZ me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale

Statusi:

Aktiviteti planifikohet të fillojë nga 15 janar 2024

Zyrtari/ja përgjegjës/e:

Drejtori i DKT

Periudha e realizimit:

Shkurt- Tetor 2023

Tjera:

/

Departamenti i Kordinimit në Terren (DKT), ka përgatit draftin e planit të veprimit për organizimin e takimeve të KQZ me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale dhe janë mbledhur informatat themelore nga ZEKZZ, lidhur me gjendjen në zyrat e tyre, duke i paraqitur secili nevojat për zyrat e tyre. Plani i veprimit ka paraparë edhe një plan të vizitave duke i'u referuar prioriteteve që janë paraqitur, si dhe në kuadër të planit është hartuar shkresa për Kryetar të komunave me të cilën do të kërkohet organizimi i takimit.

Gjatë këtyre takimeve nga KQZ do të adresohen kërkesat specifike për secilën komunë të cilat duhet të plotësohen nga administratat komunale, duke mos u fokusuar vetëm në ato të kushteve të punës, por të diskutohet edhe për qendrat e votimit në zonat urban, qasjen e personave me nevoja të veçanta në zyrat e ZE KKZ, dhe në qendra të votimit, qasje në internet etj.

Plani i veprimit të vizitave në fillim është shqyrtuar në menaxhment, pastaj është prezantuar për shqyrtim në mbledhjen e KOZ, nr.18/2023, dat.07.06.2023. Ka mbetur që Plani i veprimit të vizitave në komuna të shqyrtohet edhe njëherë në KOZ dhe të miratohet në KQZ, pas hyrjes në fuqi të Ligji Nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme (LPZ), ku do të specifikohen kërkesat e KQZ dhe nga kjo, në takimet që do të zhvillohen nëpër komuna të njoftohen palët lidhur me obligimet ligjore me ligjin e ri.

Departamenti i Koordinimit në Terren ka identifikuar të gjitha nevojta dhe kërkesat për përkrahje të Zyrarëve Ekzekutiv të KKZ, të cilat do të prezantohen në takimet me kryetarët e komunave.

Ne mbledhjen e KQZ-së Nr.31 të mbajtur me datë 23 nëntor 2023 sipas pikës 3 të rekomanduar nga Këshilli për Operacione Zgjedhore, nënpika 2 është miratuar forma e kërkesës për kryetar komune, mirëpo bazuar në sugjerimet dhe rekomandimet e KQZ-së, ky aktivitet planifikohet të realizohet nga 15 janari deri me 15 shkurt 2024, mirëpo DKT do t'i përgatit te gjitha kërkesat formale të cilat KQZ do t'ia parashtron secilit Kryetar Komune me rastin e vizitave neper komuna.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 22:

Asgjësimi i materialeve zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme dhe jashtëzakonshme, të mbajtura me datën 23 prill 2023

Statusi: Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtor i DAP-it
Periudha e realizimit: Qershor-Korrik 2023
Tjera: /

KQZ, bazuar në nenin 103.4 të Ligjit nr. 03/1.-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, brenda gjashtëdhjetë dhjetë (60) ditëve, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që janë mbajtur më datë 23 Prill 2023, do të bëjë asgjësimi i materialeve.

Më datën 26.05.2023, KQZ, nga Prokuroria e Shtetit (PSH) dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka kërkuar që të njoftohet me vendvotimet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që të mbahen më 23 prill, 2023, materialet e të cilave mund të janë objekt i hetimeve penale. Lidhur me kërkesën e KQZ, janë kthyer përgjigje nga PZAP, më datën 30.05.2023 dhe PSH me datën 19.06.2023, ku kanë njoftuar KQZ, se në këto Institucione, nuk kanë asnjë rast që mund të jetë objekt hetimi.

Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ, me vendimin nr 02/870-2023 te datës 01.08.2023 ka formuar komisionin mbikëqyrës i cili do të përgatit planin për shkatërrim e materialit zgjedhor dhe listën me vendvotimet që duhet të shkatërrohen dhe ato që eventualisht duhet të ruhen. Komisioni ka perfunduar punen me datën 14.11.2023 sipas raportit 08/27-1151-2023 për te cilin eshte asgjësuar materialet.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Rishikimi i specifikave teknike për materialet zgjedhore

Statusi: Parashihet të realizohet Në vitin 2024, pas miratimit të Rregullave Zgjedhore
Zyrtari/ja përgjegjës/e: Udhëheqësit e Njësive
Periudha e realizimit: Maj-Dhjetor 2023
Tjera: /



Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ, ka nxjerr vendimin nr.02/70 dat.24.01.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin nr.02/70/A, ka formuar komisioni për rishikimin e specifikave të materialit zgjedhor. Komisioni në fillim të punës së vet, ka bërë rishikimin, analizën dhe vlerësimin e specifikave nga zgjedhjet e kaluara duke propozuar, që specifikat distinktivëve për stafin e SKQZ, KKZ, QV, KVV, Stafit Teknik të QV dhe QNR të thjeshtësohen duke ruajtur sigurinë dhe kontrolli nga institucioni i KQZ. Thjeshtësimit këtyre specifikave mundëson që kostoja e tyre buxhetore të jetë na a lirë.

Specifikat e rishikuara kanë filluar të zbatohen për furnizime me distinktiv dhe procedurat dhe furnizimet e materialeve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, të mbajtura më datë 23 Prill 2023. Aktivitet i rishikimit të specifikat tjera të materialit zgjedhor, është duke vazhduar dhe do të përfundoj deri në muajin dhjetor 2023.

KQZ është në procesin e ndryshim - plotësimit të Rregullave Zgjedhore dhe parashihet të ketë ndryshime procedurale që do të ketë efekt edhe në vetë materialet zgjedhore që do të proces zgjedhor. Një ndër ndryshimet procedurale janë përdorimi i ngjyrës matrikuluese dhe heqja nga përdorimi i Sprejtit UV dhe Llampave UV, pastaj thjeshtimi i formularëve zgjedhor dhe ndarja e Formularëve zgjedhor të vendvotimet e rregullta nga ato me kusht.

Prandaj pas harmonizimit të Rregulloreve të reja me Ligji e ri nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme, do të fillohet me rishikimi i specifikave teknike në bazë të ndryshimit të rregullave zgjedhore.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

	Rishikimi i procedurave në bazë të ndryshimit të rregullave zgjedhore
<i>Statusi:</i>	 Parashihet të realizohet Në vitin 2024, pas miratimit të Rregullave Zgjedhore
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Udhëheqësit e Njësive
<i>Periudha e realizimit:</i>	Mars - Nëntor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Njësitë e SKQZ kanë filluar rishikimi i procedurave në bazë të ndryshimit të rregullave zgjedhore, të miratuara në KQZ, në mbledhjen nr. 06 dat.09.03.2023, mirëpo ky aktivitet është ndërprerë me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, ku KQZ ka filluar të behej harmonizimi i këtyre Rregulloreve me Ligjin e ri.

Aktualisht KQZ është në procesin e ndryshim - plotësimit të Rregullave Zgjedhore dhe parashihet të ketë ndryshime procedurale që do të ketë efekt edhe në vetë materialet zgjedhore që do të proces zgjedhor. Një ndër ndryshimet procedurale janë përdorimi i ngjyrës matrikuluese dhe heqja nga përdorimi i Sprejtit UV dhe Llampave UV, pastaj thjeshtimi i formularëve zgjedhor dhe ndarja e Formularëve zgjedhor të vendvotimet e rregullta nga ato me kusht. Ndryshimet procedurale prekin procesin e votimit të rregullt në vendvotim, numërimin e fletëvotimeve në vendvotim, votimin me kusht, numërimin e votave të kandidatëve në QKN, procesin e regjistrimit dhe votimit të votuesve jashtë vendit

Prandaj pas harmonizimit të Rregulloreve të reja me Ligji e ri nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme, do të fillohet me rishikimi i procedurave në bazë të ndryshimit të rregullave zgjedhore.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 25: **Raportimi tre mujor lidhur me zbatimin e aktiviteteve të Planit të Punës dhe buxhetit për vitin 2022 dhe raportimet për vitin 2023**

Statusi: Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e: zv.Kryeshefi i SKQZ-së
Periudha e realizimit: Janar, Prill, Korrik, Tetor 2023
Tjera: /

Raportit përfundimtar të realizimit të planit të punës të KQZ, për vitin 2022. Raporti është miratuar në mbledhjen e KQZ, nr.03/2023, dat.27.01.2023. Vendimi i KQZ, nr.01-90-2023, dat.27.01.2023.

Raportit vjetor financiar i KQZ, është shqyrtuar në mbledhjen e KBF nr. 02/2023, dat.27.01.2023, dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, nr. 03/2023, dat.27.01.2023.

Raporti i realizimit të planit të punës të KQZ, për periudhën janar-mars 2023 T(1), është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ, nr.17/2023, dat.10.05.2023, dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, nr.17/2023, dat.11.05.2023. Vendimi i KQZ, nr. 01-623/2023, i datës 11.05.2023.

Raporti i realizimit të planit të punës të KQZ, për periudhën janar-qershor 2023 (T2), është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, nr.23/2023 të datës 25.07.2023.

Raporti i realizimit të planit të punës të KQZ, për periudhën janar-shtator 2023 (T3), është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, të datës 14.11.2023.

Dhe njoftim me vlerësimin paraprak të zbatimit të planit të punës së KQZ për vitin 2023 - periudha janar - nëntor 2023, është trajtuar në mbledhjen nr.33 me datë 06 dhjetor 2023.

Raporti përfundimtar i realizimit të planit të punës së KQZ për periudhën janar - dhjetor (T4) është në fund të muajit janar 2024.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 26: **Rishikimi i planit të punës së KQZ, për vitin 2023**

Statusi: Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e: zv.Kryeshefi i SKQZ-së
Periudha e realizimit: Maj- Qershor 2023
Tjera: /

Bartësit e aktiviteteve dhe kryesuesit e grupeve punuese, kanë raportuar me datën 16 qershor 2023, për statusin e zbatimit të Planit të punës së KQZ, që përfshin periudhën: nga 01 janar deri me 30 qershor 2023. Raportet kanë pasqyruar gjendjen dhe statusin e aktiviteteve të cilat janë realizuar, aktivitetet të cilat janë në proces të realizimit, si dhe aktivitetet të cilat akoma nuk kanë filluar dhe aktivitete të cilat mund të shtyhet afati i realizimit për shkak të kohës.

Plani i rishikuar është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ, nr.20/2023, dat.29.06.2023, dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, nr.21/2023, dat.12.07.2023. Vendimi i KQZ, nr. 01-803/2023, i datës 12.07.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 27:	Hartimi i Planit të Punës së KQZ për vitin 2024
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	zv.Kryeshefi i SKQZ-së
<i>Periudha e realizimit:</i>	Dhjetor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Aktiviteti parashihet të realizohet në muajin dhjetor 2023.

Për draftimin e planit të punës është kërkuar në muajin korrik nga të gjitha Departamentet dhe Njesitë që të identifikojnë dhe përgatisin aktivitetet që planifikojnë për vitin 2024. Gjatë draftimit të Planit të Punës së KQZ për vitin 2024 përbazë do të merret strategjia e KQZ 2023-2026, plani i buxhetit i KQZ për vitin 2024 si dhe vlerësimi preliminar i zbatimit të planit të punës së KQZ 2023. Në vitin 2024 KQZ do të jetë në procesin e përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare që parashihet të mbahën në fillim të vitit 2025.

Në muajin dhjetor 2023, KQZ ka organizuar punëtori për hartimin e planit të punës së KQZ për vitin 2024.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

2.2. KORNIZA LIGJORE

Aktiviteti 28:	Grupimi dhe miratimi i legjislacionit sekondar të KQZ (rregullave të zgjedhjeve)
<i>Statusi:</i>	Nuk është realizuar Realizimi i këtij procesi parashihet që të zhvillohet në vitin 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP & Drejtor i DÇL
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar-Shtator 2023
<i>Tjera:</i>	/

KQZ, në mbledhjen nr. 06 dat.09.03.2023, ka miratuar gjithsejtë 15 Rregullore Zgjedhore, si në vijim:

1. Rregullore Nr. 02/2023 për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, e miratuar sipas vendimit të KQZ, me nr. 01-260-2023, dat.09.03.2023.

2. Rregullore Nr. 03/2023 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-261-2023, datë 09.03.2023.
3. Rregullore Nr. 05/2023 për Themelimin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-263-2023, datë 09.03.2023.
4. Rregullore Nr.06/2023 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-264-2023, datë 09.03.2023.
5. Rregullore Nr. 07/2023 Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-265-2023, datë 09.03.2023.
6. Rregullore Nr.09/2023 Regjistrimi dhe Votimit i Personave me Nevoja të Veçanta, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-267-2023, datë 09.03.2023.
7. Rregullore Nr. 10/2023 Fletëvotimet dhe Broshurat, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-268-2023, datë 09.03.2023.
8. Rregullore Nr. 11/2023 për Këshillat e Vendvotimeve, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-269-2023, datë 09.03.2023.
9. Rregullore Nr.12/2023 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-270-2023, datë 09.03.2023.
10. Rregullore Nr.13/2023 për Rezultatet Preliminare, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-271-2023, datë 09.03.2023.
11. Rregullore Nr.14/2023 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-272-2023, datë 09.03.2023.
12. Rregullore Nr.15/2023 Për Zgjedhjet e Parakohshme, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-273-2023, datë 09.03.2023.

Në lidhje me këtë aktivitet, Zyra ka përgatitur draftet e para dhe ka marrë pjesë në diskutimet në mbledhje të këshillave për tri (3) rregullore që kanë të bëjnë me zgjedhje.

Rregulloret e miratuara nga KQZ, që kanë të bëjnë që bien në zbatim nga ana e Zyrës, janë si në vijim:

13. Rregullorja Nr.01/2023, Regjistrimi dhe Funkcionimi i Partive Politike, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-256-2023, dat.09.03.2023.
14. Rregullorja Nr. 04/2023, Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të Tyre, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-262-2023, dat.09.03.2023.
15. Rregullorja Nr. 08/2023 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, e miratuar sipas vendimit të KQZ-së, me nr. 01-266-2023, dat.09.03.2023.

Mirëpo, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, duhet të behej harmonizimi i këtyre Rregulloreve me Ligjin e ri.

Zyra ka përgatitur draftet e rregulloreve që kanë të bëjnë me Regjistrimi dhe Funkcionimi i Partive Politike, Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të Tyre dhe Vëzhguesit e Zgjedhjeve. Këto draftet janë të gatshme për shqyrtim nga KQZ. qysh nga muaji gusht 2023.

Prandaj, Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ, ka nxjerr vendimin nr.02-693/2023, të dat.26.05.2023, për formimin e Grupin Punues për Identifikimin e ndryshimeve në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe harmonizimin e Rregulloreve të zgjedhjeve me këtë Ligj.

Grupi punues në matricë ka identifikuar të gjitha ndryshimet ndërmjet Ligji Nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligjit nr. 03/1-073 për zgjedhjet e përgjithshme dhe nga referencat e këtyre ndryshimeve janë hartuar edhe draftet e Rregulloreve zgjedhore të cilat janë prezantuar në punëtorin e KQZ, me temën "Harmonizimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ, me ligjin e zgjedhjeve", të mbajtur nga data 07-11 korrik në Tiranë. KQZ pritet që gjatë muajit gusht 2023, t'i miratojë këto rregullore.

Më pastaj KQZ ka autorizuar Këshillin e Personelit të udhëheqë punën për ndryshim-plotësimin e Rregulloreve të Brendshme të KQZ. Grupi punues që përbëhet nga anëtarët e Këshillit të Personelit dhe staf i Sekretariatit të KQZ janë në procesin e punës.

KQZ ka vazhduar punën me draftimin e Rregullave Zgjedhore gjatë muajit nëntor dhe fillim të muajit dhjetor 2023 dhe vazhdimin e punës do ta bëjë në janar të vitit 2024.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

	Plotësim/ndryshimi i Rregullave të brendshme të KQZ
<i>Statusi:</i>	Nuk është realizuar Realizimi i këtij procesi parashihet që të zhvillohet në vitin 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP / Drejtor i DCL / Drejtor i DAP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar -- Shtator 2023
<i>Tjera:</i>	/

Me datën 13.03.2023, është organizuar punëtorja "Hartimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ZRCKFSP, e cila është përkrahur nga UNDP - Misioni në Kosovë.

Versioni i parë i kësaj rregulloreje, e cila është shqyrtuar në këtë punëtori, ka përmbajtur gjithsejtë dhjetë (10) nene, në të cilën janë dhënë komentet. Versioni i dytë do të përgatitet për shqyrtim në punëtorinë e radhës, që do të mbahet në sallën e mbledhjeve të KQZ. Zyra është në përfundim të finalizimit të versionit, i cili do të shqyrtohet nga KQZ.

Ndërsa, sa i përket plotësimit dhe ndryshimit të Rregullave të brendshme të KQZ, nga KQZ, është kërkuar që përveç menaxhmentit të SKQZ, pjesë e grupi punues për hartimin e këtyre rregulloreve, përveç Këshillit të personelit i KQZ, të jetë edhe stafi i SKQZ.

Kryeshefit Ekzekutiv i SKQZ, ka nxjerr vendimin nr.02-666/2023, dat.22.05.2023, për stafin e SKQZ, të cilët do të jenë pjesë e Grupit Punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullave të brendshme të KQZ.

Grupi punues ka të hartua Planin dinamik për ndryshim/ plotësimin e Rregullave të brendshme me qëllim që të identifikohen hapat radhë pas radhë, dhe të cilat do të ndërmerren në kuadër të realizimit të aktiviteteve të planifikuara me Planin e punës të KQZ, për vitin 2023. Grupi punues do të hartoj draftet të cilat do të prezantojë për shqyrtim në Këshillat e KQZ dhe miratim në KQZ.

Në mbledhjen e KOZ, nr.20/2023, dat.29.06.2023, është bërë rishikimi i Planit të punës të KQZ për vitin 2023, dhe ky aktivitet është shtyrë të realizohet deri në muajin shtator 2023. KQZ në mbledhjen nr.21/2023, dat.12.07.2023, ka miratuar planin e rishikuar. Vendimi i KQZ, nr. 01-803/2023, i datës 12.07.2023, për miratimin e planit të rishikuar.

Me datën 13.03.2023. është organizuar punëtorja "Hartimi i rregulloreve për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ZRCKFSP, e cila është përkrahur nga UNDP - Misioni në Kosovë.

Versioni i parë i kësaj rregulloreje, e cila është shqyrtuar në këtë punëtori, ka përmbajtur gjithsejtë dhjetë (10) nene, në të cilën janë dhënë komentet. Versioni i dytë gjendet në fazën përfundimtare, i cili do të jetë i gatshëm për shqyrtim nga ana e KQZ.

Në KQZ në muajin dhjetor 2023 në një punëtori janë prezantuar draftet e para të Rregulloreve të Brendshme dhe vazhdimin e punës do ta bëjë në janar të vitit 2024.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Rishikimi i Udhëzimeve Administrative të KQZ

Statusi:

Realizimi i këtij procesi parashihet që të zhvillohet në vitin 2024

Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtor i DCL / Drejtor i DAP

Periudha e realizimit: Janar- shtator 2023

Tjera: /

Kryeshefit Ekzekutiv i SKQZ, ka nxjerr vendimin nr.02-134/2023, dat.08.02.2023, për formimin e Grupin Punues për rishikimin e Udhëzimeve të brendshme të KQZ.

Grupi punues ka hartuar Planin dinamik për ndryshim/ plotësimin e Udhëzimeve të brendshme me qëllim që të identifikohen hapat radhë pas radhe, dhe të cilat do të ndërmerren në kuadër të realizimit të aktiviteteve të planifikuara me Planin e punës të KQZ, për vitin 2023.

Grupi punues ka propozuar që këto Udhëzime të emërohen Rregullore duke hartuar draftet të cilat do t'i dërgoj te anëtarët e Këshillin për Çështje Ligjore (KÇL) për komente dhe sugjerime. Pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve draftet janë prezantuar për trajtim në KÇL dhe miratim në KQZ. Grupi punues ka hartuar draftet e Rregulloreve:

1. Rregulloren nr.00/2023 për Procedurën e zëvendësimeve për anëtarët e Kuvendeve Komunale,
2. Rregulloren nr.00/2023 për Shpenzimet e reprezentacionit për anëtarët e KQZ-së dhe Menaxhmentin e SKQZ-së,
3. Rregulloren nr.00/2023 për Shfrytëzimin e veturave zyrtare të KQZ-së,
4. Rregulloren nr.00/2023 për Shfrytëzimin e telefonisë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drafti i Rregullores nr. 00/2023 për Procedurën e zëvendësimeve anëtarëve të kuvendeve në komunale është shqyrtuar në mbledhjen KÇI. nr. 06/2023, dat.16.06.2023. Kjo Rregullore ka mbetur të trajtohet edhe njëherë në KCL, pastaj do të miratohet në KQZ.

Rregulloret tjera të parapara në planin e punës do të hartohen nga Këshilli i personelit dhe grupi punues i SKQZ për plotësimin dhe ndryshimin e rregullave të brendshme të KQZ. Në mbledhjen e KOZ nr.20/2023, dat.29.06.2023, është bërë rishikimi i Planit të punës të KQZ-së për vitin 2023, dhe ky aktivitet është shtyrë të realizohet deri në muajin shtator 2023. KQZ në mbledhjen nr.21/2023, dat.12.07.2023, ka miratuar planin e rishikuar. Vendimi i KQZ-së, nr. 01-803/2023, i datës 12.07.2023, për miratimin e planit të rishikuar.

Udhëzimet Administrative do të trajtohen së bashku ne Rregulloret Zgjedhore dhe Rregulloret e Brendshme dhe vazhdimin e punës KQZ do ta bëjë në janar të vitit 2024.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

2.3. GJITHËPËRFSHIRJA DHE PJESMARRJA NË ZGJEDHJE

Aktiviteti 31:	Informimi dhe edukimi i votuesve të rinj për zgjedhje	
Statusi:	Pjesërisht i realizuar	Realizimi i projektit në vitin 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DOZ	
Periudha e realizimit:	Qershor- dhjetor 2023	
Tjera:	/	

Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve, ka përgatitur draft projektin: "Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje", më datë 02.06.2023. Ky projekt ka për qëllim informimin e votuesve të rinj për të drejtën e tyre për të zgjedhë dhe për tu zgjedhur, procesin zgjedhor, sistemin dhe procedurat zgjedhore, ndikimin që mund të ketë vota e tyre në zhvillimet e përgjithshme shoqërore.

Përmeshja e objektivave të këtij projekti do të arrihet përmes organizimit të diskutimeve/ligjëratave, simulimit të votimit, shpërndarjes së materialeve informuese të cilat do të organizohen në të gjitha komunat në sallat e asambleve komunale, shtëpitë e kulturës, zyrat e këshillave të veprimeve rinore, zyrat e qendrave rinore dhe shkollat e mesme.

Këshilli rinor të Ambasadës Amerikane në shtatë qendrat regjionale, në mënyrë vullnetare do të mbështesë KQZ-në me ligjërues/trajner me eksperiencë.

Projekti është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ nr. 26/2023, me datë 19.09.2023. KQZ, nr. 28/2023, me datë 06.10.2023 ka miratuar projektin me nr. të Vendimi 01-1025-2023.

Pas aprovimit të projektit, janë përgatitur specifikat për fillimin e procedurave të prokurimit, pastaj është vazhduar me përgatitjet e materialeve dhe aktiviteteve tjera të planifikuara në projekt në koordinim me ZLKZ-të dhe Këshillin rinor të Ambasadës Amerikane.

Aktiviteti i prokurimit ka filluar me datën 09.10.2023, dhe afati për pranimin e ofertave ka qenë deri me 23.10.2023, mirëpo, nuk ka ofertuar asnjë operator.

Në mbledhjen e KQZ, nr. 30/2023 të datës 14.11.2023, u vendos që realizimi i këtij projekti, për shkak të kohës me të përshtatshme të filloj të realizohet në tremujorin e parë të vitit 2024.

Statusi i aktivitetit është: Pjesërisht i realizuar

Aktiviteti 32:	Informimi i votuesve për caktimin dhe ndërrimin e qendrës së votimit
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DOZ.
Periudha e realizimit:	Qershor- Dhjetor 2023
Tjera:	/

Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve, sipas planit të punës së KQZ 2023, ka përgatitur projektin: "Informimi i Votuesve për caktimin dhe ndërrimin e qendrës së votimit", më datë 22.05.2023. Ky projekt ka për qëllim t'i informojë votuesit për caktimin dhe mundësinë e ndërrimit të QV edhe në vitet jo zgjedhore, mënyrën e identifikimit të QV, caktimin në qendra të reja të votimit dhe të drejtën për të kërkuar ndërrimin e tyre.

Projekti është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ, nr. 22/2023, me datë 19.07.2023. KQZ, nr. 22/2023, me datë 20.08.2023 ka miratuar projektin me Vendimi nr. 01-832-2023.

Pas miratimit nga KQZ është filluar me përgatitjen e specifikave për fillimin e procedurave tenderuese. Kontrata në mes KQZ-së dhe Operatorit Ekonomik është nënshkruar me 29.09.2023.

Për fillimin e fushatës së IP-së janë përgatitur tekstet dhe dizajnet si për : posterit për shtyp, poste për rrjetet sociale, poste për portalet e lajmeve, banerët për portalet e lajmeve, video spoti, radio spoti, teksti për dërgimin e SMS qytetarëve përmes operatorit VALA, media planet për publikim dhe sponsorizim të produkteve në portale, media planet për publikim dhe sponsorizim të produkteve në rrjetet sociale, media plani për transmetimin dhe publikimin e produkteve në mjetet e komunikimit pa pagesë si dhe baneri për organizimin e konferencës për media.

Të gjitha produktet dhe media planet janë shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ, nr. 32/2023, me datë 21.11.2023. KQZ, në mbledhjen nr. 31/2023, me datë 23.11.2023 ka miratuar të gjitha produktet dhe media planet me Vendimi nr. 01/1194-2023.

Fushatë informuese nga KQZ "Mëso dhe ndërro qendrën e votimit brenda komunës", ka filluar me 24 nëntor 2023, në mjetet e komunikimit të planifikuara në projekt, po me këtë datë është mbajtur edhe konferenca për media.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

	Edukimi digjital për zgjedhje
<i>Statusi:</i>	Aktiviteti parashihet të realizohet në vitin 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DOZ
<i>Periudha e realizimit:</i>	Prill- Dhjetor 2023

Aktiviteti për Edukimin digjital për zgjedhje, kjo platformë fillimisht është menduar vetëm për edukim digjital të votuesve të financohet nga OSBE, mirëpo gjatë përgatitjes së saj u zgjerua edhe përfshirja e moduleve të trajnimit për anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe vëzhguesve

Divizioni në bashkëpunim me OSBE dhe DFI, janë përgatitur draft specifikat teknike për zhvillimin e platformës online për edukimin e votuesve, trajnimin e administratës së zgjedhjeve, vëzhguesve, bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Zgjedhjet Lokale, rregullat dhe procedurat e KQZ-së.

Qëllimi i realizimit të kësaj platforme është që çdo qytetari të interesuar t'i ofrojë mundësi për informim online për të drejtën e votës dhe procesin zgjedhor dhe trajnimin e trupave zgjedhor, testimin, vlerësimin dhe certifikimin e tyre.

Për shqyrtimin e dokumenti është organizuar edhe një punëtori një ditore me anëtarët e KOZ-it, zyrtarët nga Sekretariati dhe përfaqësues të OSBE-së.

Dokumenti "Specifikimet teknike për zhvillimin e Platformës për edukimin & informimin e votuesve dhe trajnim", është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ, nr. 25/2023, me datë 23.08.2023. KQZ, në mbledhjen nr. 25/2023, me datë 31.08.2023 ka miratuar dokumentit me Vendimi nr. 01-931-2023. Pas miratimit nga KQZ, dokumenti ju është dërguar OSBE-së, për zhvillimin e procedurave tenderuese.

OSBE ka vlerësuar se pasi që kjo platformë është zgjeruar nuk mund të realizohet brenda këtij viti dhe mbetet që të realizohet vitin 2024.

Për më tepër edhe për shkak se rregullat zgjedhore janë në procesin e plotësimit ndryshimit.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 34:	Miratimi i Listës së Qendrave të Votimit pas Analizës dhe Vlerësimit të Qendrave të Votimit
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DOZ / Drejtor i DKT/DFI
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar-Shkurt 2023
<i>Tjera:</i>	/

Departamenti i Operacioneve Zgjedhore (DOZ), në mbledhjen e KOZ, nr.06/2023, dat. 24.02.2023, ka prezantuar për shqyrtim draftin e listës së QV dhe vlerësimin e QV. Pas shqyrtimit KOZ, ka rekomanduar listën e QV për shqyrtim dhe miratim në KQZ. Lista e QV

është miratuar nga KQZ, në mbledhjen nr.05/2023, dat.01.03.2023. Vendimi i KQZ, nr.01-215-2023, dat.01.03.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 35:

Zbatimi i Periudhës së Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrave të Votimit

Statusi:

Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e:

Drejtor i DOZ

Periudha e realizimit:

Maj - Dhjetor 2023

Tjera:

/

Aktiviteti i planit të punës për zbatimin e periudhës së shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit ka ndërmarrë veprime konkrete. Është përgatitur raporti njoftues për zbatimin / fillimin e periudhës për ndërrimin e qendrave të votimit, i cili është shqyrtuar në mbledhjen e 29/2023 të KOZ-it, të mbajtur me datë 27.10.2023. Anëtarët e Këshillit për Operacione Zgjedhore janë pajtuar që zbatimi i këtij aktiviteti të fillojë me datën 24.11.2023. Me datën 24.11.2023 është aktivizuar aplikacioni për ndërrimin e Qendrave të Votimit.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 36:

Analizë e bazës së shënimeve të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës

Statusi:

Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e:

Drejtor i DOZ

Periudha e realizimit:

Janar-Mars 2023

Tjera:

/

Sekretariati i KQZ, me dat.17.03.2023 nga MFPI (Departamenti i Pensioneve) përmes e-maili, kemi pranuar bazën e të dhënave të personave duke përfshirë periudhën nga viti 2020 e deri me tani në formatin Access.

Të dhënat e pranuar nga Departamenti i Pensioneve - MFPI janë krahasuar me ekstraktin e regjistrimit qendror civil të cilin e kemi marr me datën 09.02.2023. Kjo bazë e të dhënave përmban të dhënat e personave të moshës 65 vjeç dhe mbi, e të cilët kanë qenë përfitues të pensioneve, dhe të cilëve iu është ndërprerë pensioni si rezultat i faktit të vdekjes.

DOZ, në mbledhjen KOZ, nr.09/2023, dat.29.03.2023, ka prezantuar për shqyrtim draftin e Analizës së Bazës së Shënimeve të Departamentit të Pensioneve/MFPI Sekretariati i KQZ, në mbledhjen e KQZ, nr.10/2023, dat.14.04.2023, ka prezantuar për miratim Analizën, mirëpo për arsyeje të mbajtjes së zgjedhjeve të 23 prillit 2023, ky miratim është shtyrë për një takim tjetër. KQZ, në mbledhjen nr.15/2023, dat.18.04.2023, ka miratuar Analizën e bazës së shënimeve të

Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës. Vendimi i KQZ, nr.01-567-2023, dat.28.04.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

	Rishikimi i dizajnit të fletëvotimit
Statusi:	Pas miratimit të Rregulloreve të Zgjedhjeve aktiviteti parashihet të realizohet në vitin 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i DTI-së
Periudha e realizimit:	Maj-Tetor 2023
Tjera:	/

Në kuadër të këtij aktiviteti, përfshihet formimi i grupit punues KQZ/SKQZ, mbajtja e takimeve me akterët e jashtëm Organizatave jo Qeveritare (OJQ), përfaqësues të Subjekteve Politike (SP). Pastaj, analizimi potencial i opinionit lidhur me plotësimin e fletëvotimeve, shqyrtimi i propozimeve.

Departamenti i Teknologjisë Informative (DTI) ka hartuar koncept dokumentin me veprimet e propozuara për realizimin e aktivitetit për rishikimin e dizajnit. Në draftin e raportit të vlerësimit janë marrë parasysh komentet në analizën e bërë nga OSHC-të dhe deri në fillim të muajit dhjetor 2023 dokumenti do të procedohet në KOZ për diskutim.

Aktualisht KQZ është në procesin e plotësim ndryshimit të rregullave zgjedhore.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 38:	Raporti gjinor i lidërshipt të partive politike për vitin 2021 - 2022
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	Mars-Nëntor 2023
Tjera:	/

Dokumenti "Raporti gjinor i partive politike për periudhën 2022-2023" është aktivitet i planifikuar me Planin e Punës së KQZ. Ky dokument, është hartuar duke i shfrytëzuar të dhënat nga azhurnimet vjetore për vitet 2022 dhe 2023, që deklarohen përmes "Formularit për Njoftimin e Ndryshimeve të Partisë Politike".

Raporti gjinor i partive politike për periudhën 2022-2023, është shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli për Operacione Zgjedhore, dhe është shqyrtuar dhe miratuar nga KQZ, në mbledhjen numër 30/ 2023, të mbajtur me datën 14.11.2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Organizimi i takimeve me votuesit e komuniteteve jo shumicë

Statusi:

Aktiviteti parashihet të realizohet në vitin 2024

Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtor i DOZ

Periudha e realizimit: Prill-Tetor 2023

Tjera: /

Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve ka filluar përgatitjen e projekti: "Organizimi i takimeve me votuesit e komuniteteve jo shumicë". Gjatë përgatitjes së draft projektit ka komunikuar me disa organizata si: Vision02 dhe Roma Versitas Kosova. Organizata Vision02 ka shprehur gatishmëri që të bashkëpunoj me KQZ-së dhe kanë deklaruar se këto aktivitete informuese mund të realizohen edhe tek zyrat e tyre, për arsye se kanë hapësira të mjaftueshme.

Ky aktivitet nuk arriti të realizohej për shkak të vonesave në realizimin e projekteve të tjera, po ashtu njëri prej tyre "Informimi dhe edukimi i votuesve të rinj për zgjedhje", duhej që disa produkte të këtij projekti të përdoren në realizimin e këtyre aktiviteteve.

Ky aktivitet rekomandohet që të përfshihet në strategjinë e informimit publik në vitin e ardhshëm.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 40:

Analizë e përfaqësimit të grup moshave dhe gjinisë në trupat zgjedhor për zgjedhjet e vitit 2021

Statusi:

Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtor i DKT

Periudha e realizimit: Janar - Nëntor 2023

Tjera: /

Në këtë periudhë DKT, ka vazhduar grumbullimit të dhënave nga raportet e ndryshme të vitit 2021, të përfaqësimit të grup moshave dhe gjinisë në trupat zgjedhor për zgjedhjet e vitit 2021. Aktivitet është duke vazhduar dhe pritet të realizohet në periudhën e tremujorit të katërt 2023.

Në mbështetje të planit të veprimit sipas rekomandimeve të DKT-së, saktësisht me datë 16 tetor 2023 në mbledhjen e rregullt nr.27/2023 të Këshillit për Operacione Zgjedhore është rekomanduar për shqyrtim dhe miratim Draft Raportit të DKT-së "Analizë e të dhënave të zgjedhjeve të kaluara për përfaqësim gjinor në Trupat Menaxhues të Zgjedhjeve", dhe me pas KOZ-i ka dhënë disa sugjerime të cilat DKT menjëherë i ka plotësuar dhe dokumenti në fjale është proceduar në KQZ për shqyrtim dhe miratim.

Kurse, me datë 30 tetor 2023 në mbledhjen e rregullt nr.29/2023, KQZ sipas rekomandimit të Këshillit për Operacione Zgjedhore pika 3.1 nënpika 2 ka miratuar Raportin "Analizimi i të dhënave të zgjedhjeve të kaluara për përfaqësimin gjinor në TMZ

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

2.4. INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA

Aktiviteti 41:	Zhvillimi i softuerit për numërim dhe rezultate dhe procese tjera të KQZ	
Statusi:	Pjesërisht i realizuar	Aktiviteti parashihet të komplotohet në vitin 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i DTI-së	
Periudha e realizimit:	Janar - Korrik 2023	
Tjera:	/	

Në këtë periudhë ka vazhduar puna në zhvillimin e softuerit. Nga fillimi i vitit janë mbajtur 21 takime të përbashkëta të Ekipit Mbikëqyrës, zyrtarëve nga OSBE dhe kontraktori (Cactus). Në pjesën e parë të vitit janë finalizuar specifikimet funksionale të cilat janë aprovuar nga Ekipi Mbikëqyrës dhe kontraktori. Pas kërkesës nga Ekipi Mbikëqyrës Menaxheri i Projektit nga OSBE ka kërkuar me datë 17.05.2023 nga Cactus planin e rishikuar të projektit meqë janë evidentuar vonesa. Me datë 19.05.2023 është pranuar Plani i rishikuari. Ekipi mbikëqyrës sipas së bashku dhe ndaras sipas përgjegjësive të njësive dhe zyrtarëve përkatës ka marrë pjesë në takime për prezantimin e zhvillimit dhe janë dhënë komentet. Deri me tani janë zhvilluar modulet: *Administrimi, Menagjimi i listës së votuesve, Regjistrimi i Partive dhe Certifikimi i Subjekteve Politike, Akreditimi i vezhguesve, Stafit zgjedhor*. Kanë mbetur të zhvillohen modulet: *Raportimi i rezultateve preliminare dhe Menaxhimi i rezultateve perfundimtare*. Është e evidente që përkundër planit të rishikuar zhvillimi i softuerit dhe kompletimi i aktivitetit ka vonesa për shkak të vonesave nga kontraktori për çka është vënë në dijeni donatori në këtë rast OSBE.

Statusi i aktivitetit është: Pjesërisht i realizuar

Aktiviteti 42:	Raport vlerësues për pajisjet e TI-së në KQZ
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i DTI-së
Periudha e realizimit:	Janar-Mars 2023
Tjera:	/

DTI, ka bërë vlerësimin e pajisjeve të TIK, që KQZ ka në dispozicion, ku janë vlerësuar pajisjet e blera në 10 vitet e fundit ku përfshihen kompjuterë, llaptop, serverë, pajisje për printim, fotokopjim dhe skanim. Në raport është paraqitë evidenca e pajisjet të TIK-ut, vlerësimi i funksionalitetit dhe në fund është paraqitë identifikimi i nevojave për furnizim.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 43:	Analizë lidhur me mundësinë e digjitalizimit të proceseve zgjedhore dhe administrative
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DTI-së
<i>Periudha e realizimit:</i>	Gusht - Nëntor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Është filluar puna në vlerësimin e nevojave dhe identifikimin e proceseve të brendshme dhe operacioneve zgjedhore që mund të digjitalizohen me qëllim të përmbushjes në menyrë efektive të detyrave dhe obligimeve. Analiza është ndarë në dy pjesë: pjesa e operacioneve të brendshme dhe atyre zgjedhore. Puna në këtë aktivitet është duke u vazhduar dhe pritet të përfundohet në muajin dhjetor për shkak të angazhimeve në aktivitete tjera të stafit të DTI-së.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 44:	Shqyrtimi i mundësisë për transmetimin e drejtpërdrejtë i mbledhjeve të KQZ
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtori i DTI-së / Zëdhënësi
<i>Periudha e realizimit:</i>	Prill- Qershor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Është bërë analizimi dhe vlerësimi i mundësisë së transmetimit live të mbledhjeve të KQZ, dhe janë analizuar opsionet e përdorura në dy institucione. Si përfundim është përpiluar projekti me titull: *Furnizimi me pajisje të zerimit & përkthimit për sallën e takimeve dhe transmetimin live të mbledhjeve të KQZ-së*. Projekti përmbanë: përshkrimin e gjendjes aktuale, qëllimin, përshkrimin e projektit në faza, koston financiare të paralogarit, periudhen kohore për realizimin e projektit dhe rezultatet e projektit. Projekti është aprovuar nga KQZ dhe buxhetuar nga Qeveria si projekt kapital në kuadër të planit të buxhetit për vitin 2024.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 45:	Hartimi i Dosjes se Informimit Publik
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Korrik 2023
<i>Tjera:</i>	/

Sipas nenit 43 të LPZ, Zyra, krijon dhe ruan Dosjen e Informimit Publik, ku përfshihen regjistri i donatoreve, vlera e kontributit, data në të cilën është dhënë kontributi, raportet financiar të fushatës.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 46:	Përgatitja dhe publikimi i raporteve financiare të subjekteve/partive politike
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Korrik 2023
<i>Tjera:</i>	/

Raportet vjetore financiare të subjektit politik si afat të fundit për dorëzim të tyre është 1 mars i çdo viti. Këto raport do të auditohen nga auditor të certifikuar, pas procesit të konkursit të shpallur nga Zyra.

ZRPPC i përgatit për publikim ueb faqen e KQZ-se këto raporte vjetore financiare të subjektit politik, duke i bashkangjitur raportin e auditorit nëse aplikohet.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

2.5. BASHKËPUNIMI DHE TRANSPARENCA

Aktiviteti 47:	Raportimi për procesin e dorëzimit të azhurnimeve vjetore të të dhënave të partive politike të regjistruara
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar-Shkurt 2023
<i>Tjera:</i>	/

ZRCKFSP, me dat.13.01.2023, ka dërguar njoftim për të gjitha partitë politike të regjistruara, dhe ka kërkuar që deri me dat.31 janar 2023, në orën 16:00, t'i dorëzojnë formularët e azhurnimeve vjetore. Krahas formularit që kanë qenë të obliguar ta dorëzojnë në formën fizike, partitë politike, kanë qenë të obliguara që ta plotësojnë formën elektronike në formatin Excel dhe ta dërgojnë përmes e-mailit.

Nga dyzet e nëntë (49) parti politike të regjistruara që kanë dërguar formularët e azhurnimit vjetor: a) Dyzet e gjashtë (46) parti politike të regjistruara kanë dorëzuar formularët e azhurnimit vjetorë, brenda afatit të caktuar (prej datës 13 deri 31 janar 2023), dhe b) Tri (3) parti politike të regjistruara kanë dorëzuar formularët e azhurnimit vjetor, pas datës 31 janar 2023. Të tria (3) partitë politike kanë dorëzuar formularët e azhurnimit vjetor, me dat.03 shkurt 2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 48:**Raportimi për dorëzimin e Raporteve të shpenzimeve vjetore të partive politike**

Statusi:

Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e:

Drejtor i ZRCKFSP

Periudha e realizimit:

Mars 2023

Tjera:

/

Në bazë të nenit 15, të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, si dhe nenit 7, të Rregullës nr. 14/2015, Mbi Financimin e Subjekteve politike dhe Sanksionet, subjektet e regjistruara politike obligohen që të dorëzojnë për çdo vit raportin vjetor financiar. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve ishte me datë 1 mars 2023. Dyzet e nëntë (49) parti politike si dhe dy (2) iniciativa qytetare, kanë dorëzuar raportet vjetore brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 49:**Raportimi për dorëzimin e deklarimeve të partive politike për vazhdimin e regjistrimit**

Statusi:

Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e:

Drejtor i ZRCKFSP

Periudha e realizimit:

Mars 2023

Tjera:

/

ZRCKFSP, me datën 07.03.2023, i ka njoftuar përmes e-mailit, të gjithë personat kontaktues të partive politike të regjistruara, për detyrimin që kanë, për të dorëzuar formularët e vazhdimin të regjistrimit, deri me dat.31.03.2023. Njoftimi ri kujtues, iu është dërguar edhe një herë, me datën 28.03.2023.

Deri me datën 31.03.2023, nga dyzet e nëntë (49) parti politike të regjistruar, formularët për vazhdimin e regjistrimit kanë dorëzuar:

- a) Dyzet e tetë (48) parti politike të regjistruara;
- b) Një (1) parti politike e regjistruar, nuk e ka dorëzuar formularin për vazhdimin e regjistrimit.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 50:**Raportimi tremujor nga monitorimi i kuvendeve zgjedhore të partive politike**

Statusi:

Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e:

Drejtor i ZRCKFSP

Periudha e realizimit:

Janar - Dhjetor 2023

Tjera:

/

Nga data 1 janar 2023, deri me datën 31 dhjetor 2023, janë mbajtur shtatë (7) kuvende zgjedhore të partive politike.

Nr.	PARTIA POLITIKE	DATA E MBAJTJES SË KUVENDIT ZGJEDHOR
1	KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	19.03.2023
2	PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT	23.03.2023
3	PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT	20.08.2023
4	FJALA	23.08.2023
5	POKRET ZA GORA	31.08.2023
6	PARTIA E DREJTËSISË	24.09.2023
7	RAPUBLIKANËT E KOSOVËS	17.09.2023
8	SRPSKA LISTA	24.10.2023
9	KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	05.11.2023
10	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	19.11.2023

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 51:	Trajnimi i zyrtareve financiar të subjekteve politike
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	Shkurt 2023
Tjera:	/

ZRCKFSP, me dat.21.02.2023, ka organizuar dhe mbajtur trajnimin me përfaqësuesit financiar të partive politike për hartimin e raportit vjetor financiar të shpenzimeve. Qëllimi i këtij trajnimi të rregullt kishte të bënte me mënyrën e hartimit të raportit vjetor si dhe u prezantuan gjetjet nga raportet vjetore financiare të viteve të kaluara dhe të audituara, me qëllim të mos përsëritjes së lëshimeve të mundshme. Në këtë trajnim morën pjesë dymbëdhjetë (12) parti politike të regjistruara.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 52:	Rekomandim për shqiptimin e gjobave sipas raporteve të auditimit
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Maj- Tetor 2023
<i>Tjera:</i>	/

Në lidhje me këtë aktivitet, ka filluar auditimi i raporteve vjetore financiare për vitet 2022 dhe 2021, si dhe auditimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve për dy proceset zgjedhore të vitit 2021, Zgjedhjet Lokale dhe Zgjedhjet Parlamentare 2021. Deri në fund të muajit shtator 2023, operatori ekonomik ka përgatitur dhe dërguar raportet preliminare të auditimit për vitin 2021 dhe raportet preliminare të auditimit për financimin e fushatës së zgjedhjeve dy palë zgjedhjet e vitit 2021.

Me datën 21.11.2023, Zyra ka pranuar raportet përfundimtare të auditimit. Raportet përfundimtare janë duke u vlerësuar nga Zyra, në bazë të secilës gjetje.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 53:	Historiku i Zgjedhjeve
<i>Statusi:</i>	Pjesërisht i realizuar Aktiviteti parashihet të realizohet në muajin janar 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Zëdhënësi i KQZ
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar- Shtator 2023
<i>Tjera:</i>	/

Historiku i zgjedhjeve në Kosovë, 2000 – 2021- është punuar drafti në publikimin e dytë të historikut të zgjedhjeve, por nuk është arritur që të përfundohet për shkak të angazhimeve procesin zgjedhor të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023, dhe në procesin e hartimit të strategjisë të KQZ, 2023-2026, të cilat kanë qenë të paplanifikuara.

Në mbledhjen e KOZ-it nr.20/2023, dat.29.06.2023, është bërë rishikimi i Planit të punës të KQZ, për vitin 2023, dhe ky aktivitet është shtyrë të realizohet deri në muajin shtator 2023. KQZ në mbledhjen nr.21/2023, dat.12.07.2023, ka miratuar planin e rishikuar. Vendimi i KQZ-së, nr. 01-803/2023, i datës 12.07.2023, për miratimin e planit të rishikuar.

Statusi i aktivitetit është: Pjesërisht i realizuar

Aktiviteti 54: Shënimi i "Dita Globale e Zgjedhjeve"
Statusi: Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtori i DOZ
Periudha e realizimit: Janar- Shkurt 2023
Tjera: /

Projekti "Dita Globale e Zgjedhjeve", sipas planit të punës, është shqyrtuar dhe aprovuar në mbledhjen e KOZ, nr. 01/2023, me dat.13.01.2023, dhe është aprovuar në mbledhjen e KQZ, nr. 01/2023, dat.16.01.2023. Vendimi i KQZ, nr.30/2023, dat.16.01.2023.

KQZ, më 2 shkurt 2023, ka shënuar "Ditën Globale të Zgjedhjeve", ku është mbajtur një konferencë me temën: "Pjesëmarrja në zgjedhje në Republikën e Kosovës dhe roli i institucioneve", dhe publikimi i dokumentit me përmbledhje të "Trendëve zgjedhore 2009 - 2021". Në këtë konferencë panelistë ishin z. Kreshnik Radoniqi - Kryetar i KQZ, Tomas Szunyog - Shefi i misionit të BE-së në Kosovë, Pascale Roussy - Drejtoresh e Demokratizimit të OSBE, në Kosovë dhe Eugen Cakolli - Demokracia në Veprim.

Po ashtu, pjesë e kësaj konference ishin edhe përfaqësues të institucioneve që në faza të ndryshme të procesit zgjedhor, janë pjesë relevante dhe kanë rol të rëndësishëm, si: Subjekte Politike, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Avokatit të Popullit, Komisionit të Pavarur të Mediave, Zyrës për Barazi Gjinore, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si: Instituti Demokracia për Zhvillim, Demokracia Plus, Germin, Lëvizja FOL, Roma Versitas etj.

ZE KZZ, me 03 shkurt 2023, kanë organizuar tryeza në nivel lokal, me temën "Pjesëmarrja në zgjedhje në Republikën e Kosovës dhe roli i institucioneve", me qëllim të shkëmbimit të përvojave nga pjesëmarrësit, mbi pjesëmarrjen në proceset zgjedhore gjatë viteve 2009 - 2021. Në këto tryeza morën pjesë përfaqësues lokal të subjekteve politike, të bashkësive lokale, të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Ky aktivitet u realizua në 32 komuna.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 55: Melodia e përhershme e KQZ
Statusi: Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtor i DOZ
Periudha e realizimit: Mars - Qershor 2023

Divizioni për informim dhe edukim të votuesve, sipas planit të punës, ka përgatitur konkursin për kompozimin e melodisë së përhershme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", me datë 04.04.2023. Kompozimi i melodisë së përhershme të KQZ-së, ka pasur për qëllim realizimin e një melodie të përhershme që identifikon dhe përfaqëson KQZ, gjatë dhënies së informatave dhe realizimit të produkteve të saj përmes audio dhe video mesazheve.

Konkursi është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ, nr. 17/2023, datë 10.05.2023. KQZ, në mbledhjen nr. 17/2023, datë 11.05.2023, ka miratuar konkursin për kompozimin e melodisë së përhershme të KQZ, me Vendim nr.01/624/2023. Konkursi për kompozimin e "Melodisë së përhershme të KQZ", është mbyllur me datën 5 qershor 2023, për të cilën është pranuar vetëm një ofertë dhe nuk ka qenë e mjaftueshme për të vazhduar me procesin.

Rishpallja e konkursit është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ, nr. 22/2023, dat.19.07.2023. KQZ, në mbledhjen e nr. 22/2023, me datë 20.07.2023, ka miratuar ri shpalljen e konkursit, me Vendim nr. 01/833/2023.

Konkursi është rishpallur me datë 21 korrik 2023, dhe është mbyllur me datë 21 gusht 2023, dhe janë pranuar oferta të mjaftueshme për të vazhduar me këtë proces.

Me kërkesën e Kryetarit të KQZ-së, dekani i fakultetit të arteve të muzikës ka caktuar një komisionin profesional për vlerësimin e ofertave.

Komisioni për vlerësimin e konkursit të ri shpallur për kompozimin e Melodisë së KQZ-së, ka shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat e pranuar dhe ka bërë përzgjedhjen dhe rangimin e tyre sipas detyrave të përcaktuara në vendim dhe ka dorëzuar raportin me datë 08.09.2023.

Raporti i komisioni dhe kompozimi i melodisë së përhershme të KQZ-së, është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ-it, nr. 26/2023 me datë 22.09.2023. KQZ, në mbledhjen nr. 29/2023 me datë 31.10.2023, ka miratuar raportin dhe kompozimin e melodisë, me Vendim nr. 01/1103/2023.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 56:	Takim i grupit punues për përmirësimin e Listës së Votuesve
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtor i DOZ
<i>Periudha e realizimit:</i>	Prill – Tetor 2023

Për këtë aktivitet janë paraparë të mbahen dy punëtori të grupit punës në implementimin e strategjisë për përmirësimin e listës së votuesve dhe në këto takime do të diskutohet rreth implementimeve të adresave sipas sistemit unik në bazën e të dhënave të shtetasve të Kosovës.

Takimi i parë është mbajtur me datën 30 maj dhe nga përfaqësuesit e MPB-së është thënë se pas përfundimit të pilot projektit në komuna do të përgatitet një raport dhe ai raport me konkluzione dhe rekomandime do të na prezantohet në takimin e dytë që është planifikuar të mbahet në muajin tetor.

Deri tani nuk kemi pranuar ende asnjë raport nga MPB, ndërkohë në rast se raporti përfundon deri në fund të vitit, do ta mbajmë edhe takimin e dytë të grupit punues.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

[REDAKTUAR] Dokument përmbledhës i analizave dhe raporteve të KQZ-së i temave të ndryshme

Statusi: **[REDAKTUAR]** Në proces, parashihet të realizohet në muajin janar 2024

Zyrtari/ja përgjegjës/e: Zëdhënësi i KQZ-së

Periudha e realizimit: Korrik - Nëntor 2023

Hartimi i këtij dokumenti është në proces dhe planifikohet që të finalizohet deri në fund të muajit nëntor 2023.

Statusi i aktivitetit është: Nuk është realizuar

Aktiviteti 58: Organizimi dhe mbajtja e tryezës "Njoftimi i partive politike me ndryshimet e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe obligimet e reja që dalin nga ky ligj"

Statusi: Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtor i ZRCKFSP

Periudha e realizimit: Shtator - Nëntor 2023

Tjera: /

Në lidhje me këtë aktivitet (aktiviteti nr. 59) Zyra gjatë këtij viti ka pas ndërvëprim direkt me përfaqësuesit e partive politike të regjistruara në KQZ dhe me KQZ.

- Në muajin qershor të këtij viti, drafti i parë i rregullores për financim të partive politike, është ndarë me të gjithë përfaqësuesit financiar të partive politike të regjistruara dhe subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Në fund të muajit qershor dhe në fillim të muajit korrik 2023, drafti i parë i rregullores financiare për parti politike është shqyrtuar nga ana e KQZ, që përbën draftin e dytë të këtij dokumenti;
- Në muajin korrik të këtij viti, Zyra ka zhvilluar takim me përfaqësuesit financiar të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pra, ky aktivitet është realizuar në një format tjetër dhe jo sikurse në formatin e planifikuar sipas Planit të Punës së KQZ.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

Aktiviteti 59: Analiza dhe shqyrtimi i opsioneve për vlerësimin e identifikimit elektronik të votuesve

Statusi: Realizuar

Zyrtari/ja përgjegjës/e: Drejtori i DTI

Periudha e realizimit: Janar- Dhjetor 2023

Tjera: /

Në lidhje me këtë aktivitet KQZ ka diskutuar me përfaqësuesit e ODHR për realizimin e analizimit të mundshëm të opsioneve për identifikimin elektronik të votuesve, konkretisht

për të bërë një hulumtim të mundësive për aplikimin e identifikimit elektronik të votuesve, megjithatë nuk ka patur progres në konkretizimin e veprimeve.

Statusi i aktivitetit është: Realizuar

3. PROGRESI NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS

Në planin e punës së KQZ për vitin 2023, janë paraparë të realizohen 59 aktivitete.

Në periudhën janar – dhjetor 2023 janë realizuar gjithsejtë 44 aktivitete apo 74.58% e Planit të Punës së KQZ. Disa aktivitete edhe përkundër planit që realizimin e kanë pasur në vitin 2023, për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të te realizohen dhe janë bartur për vitin 2024. Aktivitete pjesërisht të realizuara janë 4 apo 6.78% dhe aktivitete që nuk janë realizuar janë 11 apo 18.64%. Aktivitetet që nuk janë realizuar, janë të nderlidhura me ndryshimet në Rregulloret Zgjedhore dhe të Brendshme të cilat nevojitet të harmonizohen me ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe procedurat dhe aspektet tjera teknike dhe digjitale që nderlidhen me Ligjin, të cilat do të dërvojnë pas miratimit të Rregulloreve Zgjedhore.

Realizimi i aktiviteteve të Planit të Punës së KQZ 2023

Realizuar	44
Pjesërisht i realizuar	4
Nuk është realizuar	11
Gjithsejt aktivitete	59

Tabela 1. Numri i aktiviteteve të realizuara të planit të punës së KQZ 2023 për periudhën janar – dhjetor 2023



Grafika 1. Përqindja e realizimit të planit të punës së KQZ 2023 për periudhën janar - dhjetor 2023